



## Komuna e Kaçanikut



## Analiza hapësinore





## Komuna e Kaçanikut

Analiza hapësinore e territorit të një komune ka për qëllim të paraqesë gjendjen në vendbanimet e asaj komune shikuar nga aspekti ekonomik, social dhe mjedisor. Analiza hapësinore i tregon vendet ku ka probleme që lidhen me shfrytëzimin e hapësirës dhe probleme tjera, pastaj cili është trendi i zhvillimeve në hapësirë (pozitiv apo negativ) dhe në cilat vende është ai i shprehur. Në analizën hapësinore bëhet një krahasim i gjendjes së tanishme të zënjes së hapësirës (tokës) me gjendjen që ka qenë para një periudhe të caktuar kohore, tregohet dinamika, shpejtësia e kësaj zënje dhe parashikimi se çka do të ndodhë në të ardhmen nëse vazhdon dinamika aktuale e zënjes së tokës. Analiza hapësinore rekomandon zgjidhje për problemet dhe për ndalimin e trendeve negative të zhvillimeve në hapësirë. Ajo gjithashtu analizon ndikimin hapësinor të planeve dhe projekteve konkrete zhvillimore për të ardhmen që i ka komuna duke konstatuar se a do të jetë pozitiv apo negativ ai ndikim dhe a është zgjedhur hapësira adekuate për realizimin e projektit apo jo.

## Hyrje

Kosova sot po përballlet me probleme të shumta të fushave dhe karaktereve të ndryshme. Gjatë procesit të përpilimit të planit hapësinor të Kosovës, janë identifikuar 12 çështje më të rëndësishme dhe më aktuale sot në Kosovë, të cilat kërkojnë zgjidhje sa më të shpejtë. Ato janë :

- Papunësia e lartë dhe në rritje të vazhdueshme
- Varfëria e lartë dhe në rritje
- Depopullimi i vendbanimeve
- Shërbimet e ulëta shëndetësore dhe arsimore
- Degradimi i trashëgimisë natyrore dhe kulturore
- Banimi
- Humbja e tokës bujqësore
- Zonat e rrezikuara nga vërshimet dhe erozioni
- Shkalla e lartë e ndotjes dhe degradimi i mjedisit
- Shfrytëzimi joracional i resurseve natyrore
- Zhvillimi i pabarabartë ekonomik
- Vendbanimet, shërbimet dhe infrastruktura

Çështjet e listuara më sipër janë rezultat i takimeve të shumta me grupet ndërmministrorë, janë gjithashtu rezultat edhe i takimeve publike të organizuara në disa qendra të mëdha të Kosovës. Në të gjitha këto takime u arrit pajtueshmëri e plotë me listën e propozuar, për të cilat në mënyrë urgjente planet komunale e në këtë drejtim edhe Plani Hapësinor i Kosovës do të duhej të ofronin zgjidhje. Ky ishte momenti kur u propozua që së bashku me strukturat komunale të gjitha komunave të fillohet puna në analizat hapësinore komunale në mënyrë që të verifikohen dhe të rajonalizohen çështjet e listuara të cilat për rezultat përfundimtar do ta kenë pasqyrën më reale të shtrirjes së këtyre problemeve në territorin e Kosovës.

Në këtë drejtim dhe në bashkëpunim të ngushtë me përgjegjësit komunal, kemi përfunduar analizën hapësinore të çështjeve për Komunën e Kaçanikut. Ky material është një bazë e mirë e të dhënave shumë të nevojshme për hartimin e planit zhvillimor komunal, të cilat në vete duhet gjithashtu të përmbajnë udhëzime dhe zgjidhje edhe për problemet eventuale specifike komunale që nuk janë temë e kësaj analize.

Rezultat i punës së përbashkët të Institutit për Planifikim Hapësinor dhe zyrtarëve të komunës së Kaçanikut

## Përmbajtja

Profili komunal	5
Papunësia e lartë dhe në rritje të vazhdueshme	5
Varferia e lartë dhe në rritje	7
Depopullimi i vendbanimeve	10
Shërbimet e ulëta shëndetësore	10
Shërbimet e ulëta arsimore	12
Degradimi i trashëgimisë kulturore – historike	13
Degradimi i trashëgimisë natyrore	18
Humbja e tokës bujqësore	19
Banimi	22
Zonat e rrezikuara nga vërshimet dhe erozioni	24
Ndotja, degradimi dhe shfrytëzimi joracional i mjedisit	29
Zhvillimi i pabarabartë ekonomik	33
Bujqësia dhe aktivitetet bujqësore	35
Resurset natyrore, potenciale për zhvillimin e turizmit	36
Vendbanimet, shërbimet dhe infrastruktura	41
Rajonalizimi i problemeve dhe mundësive	50
Treguesit dhe kriteret e për vlerësim	55
Burimi i informatave	58

### Profili komunal

Kaçaniku si qendër administrative-qytezë daton qysh nga fundi i shek. XVI. Deri në vitin 1891 ishte nahije e Sanxhakut të Shkupit, të Vilajetit të Kosovës. Themeluesi i parë i kësaj qyteze është Koxha Sinan Pasha, i cili ndërtoi Xhaminë e cila edhe sot ekziston, një kuzhinë publike (imaret), një shkollë në afërsi të Xhamisë, dy hane, një hamam, kalanë dhe disa mullinj mbi lumin Lepenc. Mbishkrimi i varrit të shek. II të erës sonë është një dëshmi e ekzistimit të vendbanimeve në këto anë edhe gjatë kohës antike. Ky varr është gjetur gjatë viteve të 80-ta, me rastin e ndërtimit të shtëpisë së mallrave në Kaçanik, mbishkrimi i të cilit tani gjendet në Shtëpinë e Kulturës në Kaçanik. Meqenëse nëpër Kaçanik kalon magjistralla Prishtinë - Shkup, si dhe hekurudha Fushë Kosovë - Selanik (e ndërtuar në vitin 1879), e bën Kaçanikun vend të rëndësishëm me strategji të posaqme ekonomike. Komuna e Kaçanikut kryesisht ka qenë njohur për nga industria e materialit ndërtimor. Mirëpo ekzitojnë edhe kushte të volitshme për zhvillimin e blegtorisë, bletarisë, pemtarisë, zejtarisë e në veçanti kushte të mira për zhvillimin e turizmit dimëror dhe veror. Kaçaniku ka një traditë të hershme manifakturale, sidomos për prodhimin e gurit gëlqeror, rërës, drurit për ndërtimtari dhe shërbime të ndryshme zejtare. Komuna e Kaçanikut shtrihet në pjesën jugore të Kosovës, me një pozitë të volitshme geografike. Karakteristikat kryesore të komunës janë:

1. Një sipërfaqe prej 306 km<sup>2</sup>;
2. Terren malor me gryka të mprehta, kryesisht të pyllëzuara 17.293 ha (60%);
3. Sasi te mjaftueshme uji per furnizim dhe ujitje
4. Rrafshinë lumore, vendbashkim i dy lumenjëve Lepenc dhe Nerodime, kryesisht tokë e punueshme rreth 4053 ha, kopshte 4 ha, pemishte 129 ha vreshta rreth 6 ha .
5. Siperfaqe te mjaftueshme per zhvillimin e blegtorisë me rreth 6300 ha me kullosa dhe livadhe
6. Potenciale për zhvillimin e turizmit ne malet e Sharrit
7. Lidhje e mirë rrugore me Prishtinën, Shkupin, Tetovën, dhe Prizrenin;
8. Lidhje e mire hekurudhore me Serbinë dhe Republikën e Maqedonisë

Numri i banorëve në komunën e Kaçanikut vlerësohet të jetë 49300 banorë.


- Në qytet jetojnë rreth 14.000 banorë
- Në fshatra jetojnë rreth 36.000 banorë
- Dendësia mesatare e popullësisë është 163 ban/km<sup>2</sup>
- Rritja mesatare vjetore e popullësisë në këtë komunë është 0.29%.
- Ekziston dallim i vogël në strukturën gjinore (51 % meshkuj dhe 49% femra)
- Etnitetet që jetojnë në këtë komunë janë: shqiptarë ~99.99%; romë 0.01%
- Vlerësohet se në komunën e Kaçanikut, nga pjesa e popullësisë aktive, 40% janë femra dhe 60% meshkuj.
- Mundësia e rritjes së popullsisë aktive, vlerësohet në 3% për një vit
- Gjithësejt në këtë komunë janë afër 5.400 familje, me mesataren 9.2 anëtarë.

### Papunësia e lartë dhe në rritje të vazhdueshme

Aspekti më shqetësues i tregut të punës në Kosovë është shkalla e lartë e papunësisë, që reflektohet me probleme të shumta në shoqërinë kosovare. Kosova është vendi me shkallë më të lartë të papunësisë në rajon. Shkalla e papunësisë sillet rreth 50%. Veçoritë demografike në Kosovë determinojnë përbërjen e kontingjentit të punës, siç janë popullsia shumë e re dhe emigracioni. Vlerësohet se rreth 1/3 e popullsisë së Kosovës është nën moshën 16 vjeç, ndërsa rreth 60 % e popullsisë është në moshë pune. Popullsia shumë e re bën që çdo vit të rritet kontingjenti i punës. Papunësia më e lartë është te personat në moshë të re (16 – 24 vjeç), kjo moshë përfshin rreth 40 % të numrit total të papunëve. Shkalla e papunësisë paraqitet tepër e lartë tek femrat, pavarësisht nga shkalla shumë e lartë e joaktivitetit tek ato. Papunësia në Kosovë është kryesisht afatgjatë. Vlerësohet se rreth 80 % e të papunëve janë të papunë afatgjatë (të papunë për më shumë se 12 muaj). Pas analizave të bëra në komunën e Kaçanikut shihet se papunësia e lartë është një prej sfidave mjaft shqetësuese për popullatën e

kësaj ane. Sipas të dhënave nga Enti i punësimit në nivel komunal (për numrin e punëkërkesve), shkalla e papunësisë në Kaçanik është rreth 17 % (kjo vlerë është nxjerrë nga numri i punëkërkesve të regjistruar krahasuar me numrin e përgjithshëm të popullësisë, në mungesë të të dhënave për popullësinë aktive). Këto të dhëna flasin për një numër të vogël të të papunëve, por ato paraqesin të papunët apo punëkërkesit e regjistruar në këtë zyre nga vendbanimet e ndryshme të Obiliqit e në realitet ky numër është shumëfish më i madh sepse pjesa dërmuese e të papunëve nuk janë të paraqitur apo evidentuar, poashtu nuk ka qenë i evidentuar edhe numri i popullsisë aktive sipas vendbanimeve. Shkalla e papunësisë ndryshon në nivel komunal, disa vendbanime e kanë më të theksuar.


Numri i punëtorëve që bëjnë punë të pasigurtë dhe të përkohshme po rritet nga dita në ditë.



## ► Papunësia sipas vendbanimeve

Gjatë analizave të bëra në këtë komunë ka dalur se shkalla më e lartë e papunësisë është e shprehur në: Kaçanik, Hani i Elezit, Kaçanik i Vjetër dhe Biqec. Faktorët të cilët kanë ndikim më të madh në shkallën e lartë të papunësisë në këto hapësira janë të ndryshëm dhe mund të ndahen në 3 grupe: fiziko-gjeografik (kushtet natyrore), ekonomik dhe social.

- Faktori fiziko - gjeografik : vendet kodrinore malore,
- Faktorët ekonomik kanë ndikim të drejtpërdrejtë në shkallën e lartë të papunësisë në këto hapësira. Veprimtaritë ekonomike janë në shkallë më të ulët në vendbanimet e cekura më lartë. Këto kanë sipërfaqe më të vogël të tokës bujqësore, infrastrukturë më pak të zhvilluar, mungojnë aktivitetet tregtare dhe bizneset tjera.
- Faktorët social si arsimimi më i paktë (me theks të veçantë tek femrat), familjet e mëdha në numër dhe popullësia kryesisht agrare, poashtu kanë ndikuar në rritjen e shkallës së papunësisë në ato vendbanime. Në diagramin më lartë janë paraqitur vendbanimet sipas shkallës së papunësisë.



### ► Rekomandime

Në fokus të krijuesve të politikave dhe strategjisë së zhvillimit komunal duhet të jetë krijimi i vendeve të reja të punës. Organet komunale në bashkëpunim me qeverinë duhet të krijojnë strategjinë e zhvillimit, politikën përkatëse të punësimit dhe të vlerësojnë se në çfarë mase politikat ekonomike ekzistuese janë në përputhshmëri me këtë qëllim primar. Për zbutjen e shkallës së lartë të papunësisë është e nevojshme të organizohen trajnime profesionale për grupe specifike (gra, të rinj etj) duke patur për bazë kërkesat e tregut të punës, të ngritet kuadri profesional, të krijohen politika favorizuese për bujqësinë, të ripërtërihen kapacitetet

industriale, të privatizohen ndërmarrjet, kushte më të mira për kredi për NVM-të dhe bizneset familjare, të lansohet një program atraktiv për tërheqjen e investimeve të jashtme, të eliminohen pengesat në tregti me vendet fqinje etj.

Pagat minimale, benificionet për të papunësuarit, tatimet dhe kontributet për të papunët duhet të analizohen me kujdes. Organet komunale të bëjnë grumbullimin e vazhdueshëm dhe sistematik të të dhënave për trendet e punësimit-papunësisë dhe ti klasifikojnë të dhënat në mënyrë që të dihet se cila grup-moshë, gjini, etnicitet etj, është më e prekur nga shkalla e papunësisë.

### Varfëria e lartë dhe në rritje të vazhdueshme


Hulumtimet e kohëve të fundit tregojnë se varfëria në Kosovë është gjerësisht e përhapur - më tepër se gjysma e popullatës (50.3 %) jeton në varfëri, kurse 16 % e popullatës jeton në varfëri ekstreme<sup>1</sup>. Shkalla e ulët e zhvillimit ekonomik, procesi i ngadalshëm i privatizimit, shkalla e lartë e papunësisë, sidomos te të rinjtë, janë faktorë kryesorë të shkallës së lartë të varfërisë<sup>2</sup>.

<sup>2</sup> WB, maj 2004





punës, përjetojnë një rënie drastike me daljen në pension. Familjet me një prind e posaçërisht ato me kryefamiljare nëna, përbëjnë një numër të të varfërve. Papunësia e lartë e viteve të fundit pas '99 nuk duket se mund të bjerë në të ardhmen e afërt, ndërsa papunësia e tejzgatur për kryefamiljarët dhe fëmijët e tyre po i shtyn gjithnjë e më shumë familje drejt varfërisë.



Zbutja e varfërisë paraqet njërën nga sfidat më të rëndësishme për shoqërinë kosovare në rrugën e saj drejt së ardhmes.

► **Rekomandime të cilat do të ndihmonin në zvogëlimin e shkallës së varfërisë :** Krijimi i kushteve më të mira në zonat kodrinore – malore, sigurimi social të ngritet në nivelin e duhur dhe ti përgjigjet një pjese të konsiderueshme të popullatës e cila nuk ka mundësi materiale, ofrimi i shërbimeve arsimore, krijimi i kushteve më të favorshme në zona rurale, hapja e vendeve të reja të punë, të shpejtohet procesi i privatizimit, të papunët si shtresë e rrezikuar e shoqërisë duhet të gëzojnë të drejtën në kompensim material, të rritet mundësia e punësimit për personat me aftësi të kufizuara, përkrahja e familjeve me fëmijë me aftësi të kufizuara mentale ( të kenë prioritet në punësim), mbrojtja sociale e fëmijëve si e drejtë elementare e tyre, përkrahja dhe sigurimi i banimit për të pa strehët, të inkurajohet aktiviteti i femrës në shoqëri etj. Zhvillimi i infrastrukturës fizike (rrugët, rrjeti i shpërndarjes së energjisë elektrike, sistemet e ujitjes, ujësjellësit, kanalizimet e ujrave fekal, telekomunikacioni) dhe rrjedhimisht zhvillimi i shërbimeve publike do të ndikojnë pozitivisht në uljen e shkallës së varfërisë në këto hapësira.

## Depopullimi i vendbanimeve

Depopullimi është proces kompleks që po vazhdon në territorin e Kosovës, kryesisht në zonat kodrinore malore me lartësi të madhe mbidetare etj. Kjo dukuri është prezente edhe në komunën e Kaçanikut e më e theksuar është në vendbanimet të cilat janë më larg nga qendra e qytetit. Kjo ndodhë për shkak të kushteve të vështira që mbretërojnë në këto vendbanime, kushte që krijohen nga faktorët natyror, ekonomik, social, infrastruktura e pazhvilluar, niveli i ulët i shërbimeve etj. Për shkak të koncentrimit më të madh të veprimtarive ekonomike, si atyre industriale dhe shumë veprimtarive tjera në Kaçanik, të cilat janë më atraktive për numrin e madh të të papunësuarve në fshatra që në rrethanat e futjes së mekanizimit në bujqësi mbesin pa punë, ndodhë që shumë prej tyre të kërkojnë punë jashtë bujqësisë dhe fshatit. Këto rrethana ekonomike sociale ndikuan në lëvizjen e popullësisë drejt qendrave urbane si në Kaçanik por edhe në vende tjera duke u shndërruar nga migrues ditor e javor në migrues të përhershëm. Pasojat negative të emigrimit janë: lënja e tokave bujqësore pa u punuar, largimi i fuqisë së re punëtore, largimi i personave të shkolluar, zvogëlimi i martesave dhe lindjeve, paraqitja e dukurive deviate tek fëmijët dhe të rriturit etj. Pasojat negative të imigrimeve janë : rritja e çmimit të banesave, rritja e shpenzimeve, rritja e dukurive negative, zgjerimi pa plan dhe pa kontrollë i qyteteve etj.

## ► Rekomandim


Krijimi i kushteve më të favorshme në zonat rurale, hapja e vendeve të reja të punës, zhvillimi i politikave të favorshme sidomos në bujqësi, lansimi i një programi atraktiv për tërheqjen e investimeve të jashtme, përmirësimi i infrastrukturës etj, do të ndihmonin në përmirësimin e kushteve të jetesës të kësaj popullate.

## Shërbimet e ulëta shëndetësore

Bartëse kryesore e kujdesit primar shëndetësor në komunën e Kaçanikut është Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare me tri qendra të mjekësisë familjare dhe tetë ambulanca shëndetësore. Paraqitja sa më reale e nivelit të shërbimeve arsimore në komunën e Kaçanikut është realizuar përmes analizës së indikatorëve si:

- objekti shëndetësor/nr. banorëve
- gjendja fizike e objekteve
- kuadri shëndetësor/nr. banorëve
- kuadri përkatës – kualifikimi i personelit mjekësor
- largësia e shërbimeve shëndetësore

## Shtrirja hapësinore e shërbimeve shëndetësore dhe niveli i tyre




Niveli i ulët i shërbimeve shëndetësore vërehet në QMF-në e Hanit të Elezit, QMF-në e Doganajt, ambulancën e vendbanimit të Kotlinës, Gorancës dhe në ambulancën e vendbanimit Gurëzi (Shtrazhës).

Niveli mesatar i shërbimeve shëndetësore vërehet në ambulancën e vendbanimit të Dubravës dhe në ambulancën e Bicajt.

Niveli i lartë i shërbimeve shëndetësore vërehet në QKMF-në e Kaçanikut, QMF-në e Kaçanikut të Vjetër, ambulancën e Begracës dhe të Stagovës.

#### Mungesa e shërbimeve shëndetësore



#### Rekomandim

Objekti shëndetësor në raport me numrin e banorëve plotëson kushtin 1 Ambulancë/6000 banorë, 1 QMF/10.000 banorë, 1 QKMF/100.000 banorë që don të thotë se komuna e Kaçanikut mbulohet sa i përket objekteve shëndetësore.

Gjendja e dobët fizike e objektit vërehet në QKMF-në e Kaçanikut, QMF-në e Hanit të Elezit, dhe në QMF-në e Kaçanikut të Vjetër. Sistemi shëndetësor në komunën e Kaçanikut ka nevojë për investime të mëtejshme si në objekte, infrastrukturë ashtu edhe në mjete të punës.

Kuadri i mjaftueshëm në raport me numrin e banorëve nuk e plotëson kushtin 1 mjek + 2 motra/2000 banorë i përcaktuar nga Ministria e Shëndetësisë. Mungesa e kuadrit vërehet sidomos në ambulancën e Kotlinës, Gorancës, Gurëziut (Shtrazesh), pastaj në ambulancën e Dubravës, Bicajt dhe në QMF-në e Hanit të Elezit. Poashtu vërehet qartë se kuadri aktual shëndetësor është i paspecializuar. Lidhur me këtë duhet punuar në zhvillimin e kapaciteteve të reja superiore si dhe në aftësimin e atyre ekzistuese.

Popullata e vendbanimeve që graviton sidomos në QKMF-në e Kaçanikut, QMF-në e Hanit të Elezit, pastaj në QMF-në e Doganajve, ambulancën e Dubravës, Kotlinës si dhe banoret e vendbanimit Gurëzi duhet të rrugëtojnë gjatë deri te këto shërbime shëndetësore. Rekomandohet që në këto vendbanime të lehtësohet mundësia e qasjes në shërbimet shëndetësore duke organizuar transport për popullatën.


## Shërbimet e ulëta arsimore

Sistemi i edukimit në komunën e Kaçanikut është i organizuar në tri nivele: edukimi parashkollor, fillor dhe i mesëm. Në analizë është trajtuar vetëm arsimi fillor edhe atë shkollat fillore të plota të pavarura si dhe arsimi i mesëm.

Në komunën e Kaçaniku funksionojnë 13 shkolla fillore dhe tri shkolla të mesme. Paraqitja sa më reale e nivelit të shërbimeve arsimore në komunën e Kaçanikut është realizuar përmes analizës së indikatorëve si:

- sipërfaqja shkollore/nr. nxënësve
- gjendja fizike e objekteve
- kuadri arsimor/nr. nxënësve
- kuadri përkatës – kualifikimi i mësimitdhënësve
- largësia e objekteve shkollore

Shtirja hapësinore e shërbimeve arsimore dhe niveli i tyre




® Në hartë është i paraqitur vetëm niveli i shërbimeve në shkollat fillore, ndërsa në grafikun e mëposhtëm paraqiten edhe mungesat e shërbimeve në shkollat e mesme.

Niveli i ulët i shërbimeve arsimore vërehet në shkollën fillore të Kaçanikut, Hanit të Elezit, Bobit, Bicajt dhe shkollës fillore të Begracës.

Niveli mesatar i shërbimeve arsimore vërehet në shkollën fillore të Lirishtës, dhe Stagovës.

Niveli i lartë i shërbimeve arsimore vërehet në shkollën fillore të Doganajt, Kaçanikut të vjetër, Qafëshqipes (Gllboçicës), Lumbardhit (Kotlinës), Ivajës, dhe shkollës fillore të Elezajt.

## Mungesa e shërbimeve arsimore

**Rekomandim**

Mungesa e hapësirës shkollore është e shprehur në shkollën fillore të Kaçanikut, Bobit, dhe Begracës. Për këtë arsye rekomandohet zgjerimi apo ndërtimi i objekteve të reja shkollore në këto vendbanime.

Gjendja e dobët fizike e objekteve sidomos vërehet në shkollën fillore të Begracës, pastaj në shkollën fillore të Kaçanikut, Hanit të Elezit, Doganajt, Bobit, Lirishtës (Dubravës), dhe në shkollën fillore të Stagovës. Shkollat kanë nevojë për investime në objekte, kanalizim, ujësjellës në rregullim të oborreve dhe të fushave sportive dhe paisje me laboratore, kabinete dhe punëtori me mjete të nevojshme konkretizuese arsimore.

Kuadri i mjaftueshëm, pra raporti nxënës – mësimdhënës plotëson kushtin 22nx./1 mësimdhënës i përcaktuar nga MASHT.

Mungesa e kuadrit përkatës respektivisht kualifikimit të mësimdhënësve vërehet në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme. Sidomos kjo mungesë shprehet në shkollën fillore të Ivajës pastaj në shkollën e mesme profesionale të Kaçanikut dhe në gjimnazin teknik të Hanit të Elezit.

Nxënësit e komunës së Kaçanikut kalojnë distanca të gjata deri në shkollë. Sidomos nxënësit e vendbanimeve që gravitojnë në shkollën e mesme profesionale të Kaçanikut dhe në gjimnazin teknik të Hanit të Elezit duhet të rrugëtojnë gjatë deri në shkollë. Gjithashtu edhe nxënësit e vendbanimeve që gravitojnë në shkollën fillore të Bicajt dhe nxënësit e shkollës fillore të Begracës, kalojnë distanca të gjata të rrugës deri në shkollë. Gjithashtu duhet të përmendet se në lokalitetet rurale vijueshmëria e vajzave në shkolla është e vogël dhe atë kryesisht në vendet ku nuk ka qenë e mundur të organizohet klasa e nëntë për nxënëset që kanë mbaruar klasën e tetë. Rekomandohet që në këto vendbanime të lehtësohet mundësia e qasjes në shërbimet arsimore duke organizuar transport për nxënës.

**Degradimi i trashëgimisë kulturo - historike****Historia e Kaçanikut**

Kaçaniku si qendër administrative-qytezë daton qysh nga fundi i shek. XVI. Deri në vitin 1891 ishte nahije e Sanxhakut të Shkupit, të Vilajetit të Kosovës. Themeluesi i parë i kësaj qyteze është Koxha Sinan Pasha, i cili ndërtoi xhaminë e cila edhe sot ekziston, një kuzhinë publike, një shkollë në afërsi të xhamisë, dy hane, një hamam, kalanë dhe disa mullinj mbi lumin Lepenc. Mbishkrimi i varrit të shek. II të erës sonë, i gjetur në vitet e 80-ta me rastin e ndërtimit të shtëpisë së mallrave në Kaçanik, është një dëshmi e ekzistimit të vendbanimeve në këto anë edhe gjatë kohës antike. Ky mbishkrim tani gjendet në Shtëpinë e Kulturës në Kaçanik. Rruga magjistrale Prishtinë -Shkup, si dhe hekurudha Fushë Kosovë - Selanik (e ndërtuar në vitin 1879) që kalojnë nëpër Kaçanik, e bëjnë Kaçanikun vend strategjik me potencial për zhvillim ekonomik.

Kaçaniku lidhet me dy vendkalimet kryesore kufitare me Maqedoninë – Hanin e Elezit dhe Glloboçicën, përmes të cilave hyjnë 70% të mallrave të importuara në Kosovë.



### <sup>3</sup>Turizmi

Kaçaniku edhe pse dallohet me pozitë mjaft të mirë për zhvillimin e turizmit, me shpatijet e Sharrit, grykën e Kaçanikut, pasuritë ujore (në Kaçanik kalojnë dy lumenj), nuk ka objekte të mjaftueshme hotelere për nevojat e turistëve që do të shkonin në këtë rajon (ekzistojnë projektet e dy qendrave rekreative - sportive të cilat ende nuk janë realizuar).



### <sup>4</sup>Trashëgimia kulturore

Trashëgimia kulturore e kësaj ane përmbanë një pasuri të madhe vlerash shpirtërore e materiale, me ngjarje e shkatërrime tragjike edhe të këtyre vlerave që nga antika e deri sot. Sipas të dhënave dhe zbulimeve historike e arkeologjike, edhe komuna e Kaçanikut, pjesë e Dardanisë antike, është tejet e pasur me vlera materiale autoktone. Zbulime arkeologjike janë gjetur në Bob, Kaçanik, Kaçanik të Vjetër, Runevë, Han të Elezit etj. që datojnë nga shekulli i II. të e.s.

Numri i monumenteve në këtë komunë është 61. Sipas të dhënave të Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës dhe

të dhënave plotësuese nga institucionet komunale të Kaçanikut, janë evidentuar këto monumente:

1. Lokacioni arkeologjik "Te Kisha" (shek. XVI) – Bob;
2. Lokacioni arkeologjik "Pasuria e Krasniqëve" (Periudha Romake) – Kaçanik i Vjetër;
3. Lokacioni arkeologjik "në pasurinë e Rexhep Kasës" (lokaliteti e quan "Kisha e Kasës v.j.) – Malësi;
4. Kalaja antike dhe e Periudhës Osmane (XIV-XV) – Kaçanik;
5. Kalaja – Lumbardh;
6. Mbishkrim varri (shek. II i erës sonë), zbuluar në vitet e '80;
7. Mbishkrim kushtuar perëndisë ilire Andinus, zbuluar rreth 5 decenie më parë;
8. Varret Shqipëtare Muslimane (XX) – Runevë;
9. Varret e Vjetra Shqipëtare të Krishtera – Bicaj;
10. Varret Shqipëtare Muslimane – Rrezanë;
11. Varret e Spahive – Lenishtë;
12. Varret e Vjetra Shqipëtare Muslimane (XVIII) – Nikaj;
13. Varret e Latinëve – Kamenicë (lokaliteti e quan me mikrotoponim Roga v.j.);
14. Varret Shqipëtare Muslimane – Guranë;
15. Varret e Vjetra Shqipëtare "Lisi i Kishës" – Semajë;
16. Varret e Vjetra Shqipëtare – Sopot;
17. Varret Shqipëtare Muslimane (XIX) – Stagovë;
18. Varret Shqipëtare Muslimane "Kulla" – Qafëshqipe;

<sup>3</sup> Strategjia e zhvillimit ekonomik të komunës së Kaçanikut (2003-2006)

<sup>4</sup> AZHK - Kaçanikut

19. Varret Shqipëtare Muslimane (XIX) – Kaçanik i Vjetër;
20. Varret e Vjetra Shqipëtare Muslimane (XVIII) – Bicaj;
21. Tyrbja e Musa Kesexhisë – Kaçanik;
22. Xhamia e Koxha Sinan Pashës (1594 – 95) – Kaçanik;
23. Xhamia me varre dhe Tyrbja e Sheh Sinanit – Doganaj;
24. Xhamia (XIX) – Burim i Epërm;
25. Xhamia – Lumbardh;
26. Xhamia me varre – Ivajë;
27. Xhamia e fshatit – Guranë;
28. Mulliri rreth 500 vjeçarë në Lumas (ishë Provoli), i njohur më vonë si Mulliri i Bajram Nikës, tani pronë e haxhi Reshat Gurit;
29. Muranat (mbeturinat) e Kishës së Vjetër – Guranë;
30. Muranat e kishës së vjetër – Kodërtrim;
31. Themelet e Kishës së Vjetër – Bajë;
32. Rruga e vjetër Shkup – Selanik në Lenishtë;
33. Oda e Xhemajl Tronit (XIX) – Trimor;
34. Oda e Rexhep Gurit (XIX) – Nikaj;
35. Shtëpia folklorike fshatare (XIX) – Stagovë;
36. Vendi i ashtuquajtur “Te Kisha” – Bleranë;

Duhet theksuar se shumë monumente antike mendohet se janë zhdukur plotësisht dhe në të shumtën e rasteve dalin vetëm në toponiminë e kësaj treve, ndërkohë që objektet e vjetra, për arsye të rrethanave historike, në pamundësi të mbikqyerjes institucionale gjithashtu vazhdojnë të humbin gjurmët ose të dëmtohen shumë.



## Trashëgimia kulturore Gjendja ekzistuese





KOMUNA E KAÇANIKUT - Monumentet me status të mbrojtjes					
	nr.	objekti / tërësia	vendbanimi	viti i shpalljes	Komente
Monum. Arkeol.	1	Lokaliteti arkeologjik "Te kisha" shek.XVI, nr.V.E.K.03-102/1-4/82	Bob (III - I)	1982	
	2	Mbeturinat e kalasë së vjetër të Kaçanikut shek.XIV-XV, nr.V.E.K.02-979/67	Kaçanik (I - 6)		
Mon. kult muslimane	3	Xhamia e Sinan Pashës nr.V.E.K.02-168/66	Kaçanik (I - 5)	1966	
	4	Tyrbja e Musa Kesexhisë shek.XX, nr.V.E.K.02-953/67	Kaçanik (I - 7)	1967	Kjo tyrbe sot nuk ekziston, është e rrënuar (gjatë luftës diku më 1999)

#### Rekomandim:

- Në mënyrë që të arrihet harmonizimi i aktiviteteve në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, është i domosdoshëm bashkëpunimi i drejtorive komunale për kulturë me Institutet për mbrojtjen e monumenteve kulturore, MKRS-Departamentin e kulturës dhe me MMPH-Institutin për planifikim hapësinor. Ky bashkëpunim do të mund të rezultonte me identifikimin e gjendjes reale të pasurive të shumta të monumenteve kulturoro-historike që ka Kosova në tërësi dhe Komuna në veçanti dhe me mbrojtjen, ruajtjen, konservimin, zhvillimin dhe promovimin e tyre;
- Respektimi i legjislacionit (ligjit për planifikim hapësinor, ligjit për trashëgimi kulturore) do të mundësonte ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe historike të komunës dhe zhvillimin mbi bazën e kësaj trashëgimie;
- Nevojiten përpjekje të autoriteteve komunale për ngritjen e vetëdijes së popullatës vendase për rëndësinë e trashëgimisë kulturore;
- Të bëhet shenjëzimi i monumenteve që kanë status të mbrojtjes dhe monumenteve tjera të rëndësishme për komunën (të vihen shenjat e identifikimit të monumentit, në afërsi të tyre). Kjo do të ishte edhe ndihmesë për turistët që e vizitojnë këtë rajon;
- Katalogu i komunës është shumë i rëndësishëm sepse përmes tij me pak fjalë dhe fotografi do të promovoheshin pasuritë dhe potencialet e komunës së Kaçanikut me qëllim që të nxitet zhvillimi i gjithëmbarshtëm i saj.

## Degradimi i trashëgimisë natyrore

Komuna e Kaçanikut kryesisht ka qenë njohur për nga industria e materialit ndërtimor, por ekzitojnë edhe kushte të volitshme për zhvillimin e blegtorisë, bletarisë, pemtarisë, zejtarisë e në veçanti për zhvillimin e turizmit dimëror dhe veror.

Kaçaniku ka një traditë të hershme të manifakturës dhe privatizmit, sidomos për prodhimin e gurit gëlqeror, rërës, drurit dhe shërbimeve të ndryshme zejtare.

<sup>5</sup>Kaçaniku vlerësohet si njëra ndër trevat më të pasura shqiptare me pyje të bollshme e të bukura. Bjeshkët kaçanikase, të njohura gjithandej në rajon, e bëjnë këtë trevë joshëse për vizita. Ato që e bëjnë të veçantë në këtë aspekt janë :

- Maja e Lubotenit (2499m') – një ndër majat me te larta të maleve të Kosovës, gjatë stinës së dimrit vizitohet nga turistë të shumtë vendorë por edhe të huaj. Është një zonë shumë joshëse për turistë, me pyjet e dendura përreth, me ujë të pastër etj. Gjatë stinës së verës, Kaçaniku me rrethinë merr pamje magjepsëse dhe tërheqëse për vizitorë të ndryshëm.
- Gryka e Kaçanikut - ka një bukuri natyrore të spikatur dhe rëndësi historike specifike për mbarë shqiptarët. Aty u zhvilluan beteja të njohura për çështjen kombetare. Të gjitha këto e bëjnë tërheqëse për shumë vizitorë nga Kosova dhe trevat tjera shqiptare.

Në këtë rajon nuk kemi ndonjë monument natyror me status të mbrojtjes, përveq parkut nacional “Mali i Sharrit” ku komuna e Kaçanikut ka një sipërfaqe prej 1560ha nga gjithësej 39000ha sa i ka i gjithë parku. Pasuritë pyjore të bjeshkëve kaçanikase, vargamalet e shumta me pasuri ujore dhe peisazhe natyrore, janë potenciale të mjaftueshme për zhvillimin e turizmit në këtë komunë. Në hartë kemi të paraqitur gjendjen ekzistuese të resurseve natyrore të komunës së Kaçanikut.

Trashëgimia natyrore  
Gjendja ekzistuese



## Rekomandim:

- Të respektohen parimet udhëzuese të politikës për mbrojtjen e mjedisit;
- Respektimi i legjislacionit si ligjit për planifikim hapësinor, ligjit për mbrojtjen e mjedisit dhe ligjit për mbrojtjen e natyrës do të mundësonte mbrojtjen e mjedisit konform zhvillimit të qëndrueshëm në Kosovë;
- Bashkëpunimi i pushtetit qendror (MMPH, MKRS dhe MTI), Instituteve për mbrojtjen e mjedisit dhe pushtetit lokal (drejtoritë për mjedis) është i domosdoshëm me qëllim të harmonizimit të aktiviteteve në mbrojtjen e trashëgimisë natyrore si potencial i zhvillimit të gjithëmbarshëm të Kosovës;
- Të stimulohet zhvillimi i turizmit me investime në infrastrukturën teknike dhe në objektet turistike përmes promovimit të vlerave të trashëgimisë natyrore që i ka kjo anë. Kjo do të ndikonte edhe në rritjen e zhvillimit të gjithëmbarshëm të komunës në veçanti dhe të Kosovës në përgjithësi.

<sup>5</sup> Nga web. faqja - Wikipedia.org

### Humbja e tokës bujqësore

Kosova ka një sipërfaqe prej afro 1.1 milion ha, nga e cila 53 % është tokë bujqësore. Prej sipërfaqes së përgjithshme të tokës bujqësore, 88 % është në pronësi private dhe 12% është në pronësi të ndërmarrjeve shoqërore. Në Kosovë dendësia e popullsisë është 204 banorë/km<sup>2</sup>. Sipërfaqja e tokës punuese për kokë banori vlerësohet se është rreth 0.15 ha.

Viteve të fundit humbja e tokës bujqësore është shumë intensive. Nuk ka të dhëna të sakta por vlerësohet se në Kosovë humbin rreth 2600-3000ha në vit. (burimi: MBPZHR , Raport mbi gjendjen e tokave bujqësore që janë atakuar nga ndërtimet e egra dhe propozimi i masave për parandalimin e kësaj dukurie).

Në mungesë të mbrojtjes institucionale, Kosova humbë tokë bujqësore në forma të ndryshme.

Mënyrat e humbjes së tokës bujqësore janë :

Humbjet e përhershme të tokës :


- Rrugët
- Akumulimet e ujit
- Aeroportet
- Ndërtesat e mëdha

Humbjet e përkohshme të tokës :


- Mihjet sipërfaqësore
- Eksploatimi i rërës, zhavorrit dhe argjilës
- Hedhurinat e automjeteve (deponitë)
- Mbeturinat industriale
- Mbeturinat komunale
- Procesi i erozionit, degradimit, gërryerjet e lumenjve etj.

Tokat e klasit të I,II,III dhe IV janë toka të mbrojtura me ligjin mbi tokat bujqësore.


Komuna e Kaçanikut favorizohet nga kushtet e përshtatshme natyrore (klima, ndërtimi pedologjik, hidrografia) për zhvillimin e bujqësisë. Pjesa e ulët fushore e cila shtrihet përgjatë lumit Lepenc është tokë shumë pjellore dhe me kushte të mira për kultivimin e kulturave bujqësore. Pjesët në jugperëndim dhe juglindje të komunës kanë lartësi më të madhe mbidetare dhe konsiderohen si vise kodrinore-malore me toka më pak pjellore.



### ► Fondi i tokës



Shpërndarja e tokave bujqësore ne raport me tokat tjera sipas vendbanimeve



Vendbanimet	Sipërfaqja	Livadhet dhe ara	Oborret	Ndërtimi	Ara me dritëra	Perime	Pentani dhe vreshari	Arat	Pyjet
Baja	319.45	97	5.5	1.5	43	0.7	2.4	67	175
Begrac	1139.6	503	27	4.5	270	2.5	13.5	256	508
Bicaj	968.34	336.5	19.2	3.5	37	2.7	7.8	246.5	612
Bob	255.14	71	21	4	12	1.5	5.8	163	254.8
Vataj	317.04	134.7	14.8	4.5	70	2.5	10.8	136	64.9
Vertomic	438.61							67.4	367.7
Gajre	374.93	92.5	5.6	1.3	25	1.2	2.6	92.7	212
Qafshqipe	1412.15	211.5	15.9	4	15	1.5	4.8	682	617
Guranë	2082.23	202.9	12.2	3.5	5	0.8	2.3	106	795
Guras	144.58	53.8	6.1	1	25	0.7	1.9	37	65
Dimcë	191.02	39	1.6	0.6	3	0.1	1.3	46.2	134
Doganaj	237.62	124.3	10	2.5	55	1.2	2.9	88.6	27.4
Drenushë	360.16	114.2	1.5	0.9	10		1.5	134.2	204
Dërmjak	615.21	33.2	1.2	0.3	5		0.6	75	526.2
Duraj	170.68	84	11	2.1	55	0.8	1.2	36.8	55.2
Hani I Elezit	116.24	13.2	44	23	5	0.9	1.4	15	3.5
Kodertrim	1173.21	111	3.8	0.7	7	0.3	3.8	204	920
Elezaj	273.38	194	8.8	1.3	35	0.3	4.2	174	39
Ivaj	742.64	107.2	7.8	1.2	35	0.8	1.3	211.4	458.5
Kaçanik	1714.06	209	64	28	30	0.9	3.2	274	1244.5
Trimor	570.38	124	8	3	40	2.1	6.5	120.5	339
kurbali	1566.48	224	3.2	0.7	7	0.2	1.3	338	1195.5
Lumbardhi	1078.43	191	7.3	1.4	25	0.7	5.5	318	693.8
Kryenik	1227.99	146.5	3.5	1.2	20	0.2	0.1	192	625
Demiraj	437.75	27.9					0.3	73.4	354.7
Nikaj	328.89	126.4	12.6	2.5	60	1.5	4.5	88.5	117.3
Nikoc	499	96.8						105.4	368.5
Paldenicë	404.38	135	14	4.6	8	1.1	2.1	168	171.3
Puset e Nikës	1087.28	112.9	3.5	0.9	15		5.2	277.2	735.4
Rrezanë	850.91	133.5	5.5	1.5	5	0.2	0.7	280.5	227.4
Malsi(Rekë)	217.96	135.5	8.5	2.2	25	1.5	15.7	124	26
Runev	575.75	49.8	9.4	1.8	8	0.6	1.1	55.6	485
Semaj	257.08	72	2.1	0.5	12	0.2	0.9	66	165
Burim	844.76	102	17.2	4.5	7	1.5	1.3	150.4	600.5
Bleran	2141.87	105	3.3	1	4	0.2	8.2	641	1362.8
Sopot	462.69	237.8	10.9	2.4	60	1.5	7.3	168.8	101
Stagov	1205.71	148.2	15.2	4.5	25	1.2	2.8	294.3	830
Kaçanik I vjeter	995.32	363	30.5	5.5	90	2.5	6.5	395	406.2
Gurëzi	1151.32	128.5	3.6	0.8	10	0.4	2.1	326.5	78.8
Koxhaj	295.28	241.5	13.6	1.7	65	0.8	2.6	190.9	16
Gjithsej		5633.3	452.9	129.1	1228	35.8	148	7486.8	27382.9


Të dhënat e përgjithshme për vendbanimet

Përqindja e pjesëmarrjes së tokës bujqësore në tokën e përgjithshme të një vendbanimi në komunën e Kaçanikut, dallon nga vendbanimi në vendbanim. Dhjetë vendbanime kanë kushte te volitshme për zhvillimin e bujqësisë në të cilat përqindja e tokës bujqësore sillet 50-70%. Në 4 vendbanime kjo përqindje sillet 40-49%, në 12 vendbanime 29-39%, në 7 vendbanime 19-29% dhe në 3 vendbanime, nën 19% e sipërfaqes së përgjithshme është tokë bujqësore.

Humbja më e theksuar e tokës bujqësore është në të dy anët e aksit rrugor Ferizaj - Kaçanik dhe Ferizaj - Qafshqipe ku janë ndërtuar objekte ekonomike.

Sipërfaqja e përgjithshme e tokës në Komunën e Kaçanikut është 29421 ha prej të cilëve 17302 ha janë sipërfaqe pyjore në të dy sektorët privat dhe shoqëror. Në sektorin privat janë 5253 ha ndërsa në sektorin shoqëror janë 12046 ha kryesisht të llojit të ahut, dushkut, shkozës etj.

Sipërfaqja e tokës së punueshme është 10516 ha, prej të cilëve 6301 ha janë të evidentuar si livadhe dhe kullosa kurse tokë lavërtare janë 4215 ha.




Shpërndarja e sipërfaqes tokësore në komunën e Kaçanikut:

Tokë bujqësore	Pyje	E paplleshme	Sip. e përgjithshme
10516 ha	17302 ha	1603 ha	29421 ha
35.7	58.8	5.4	100 %

Kategoritë e tokës bujqësore

Tokë lavërtare	Livadhe	Kullosa	Gjithsejt
4215 ha	2238 ha	4063 ha	10516 ha
40.1	21.3	38.6	100 %



Edhe pse të gjitha shënimet tregojnë se komuna e Kaçanikut ka 4215 ha tokë lavërtare, gjendja në teren ndryshon dukshëm. Migrimet e popullatës nga fshati në qytet kanë rezultuar me zvogëlimin e dukshëm të sipërfaqeve të mbjellura me kultura lavërtare. Mund të thuhet se sot sipërfaqja lavërtare është rreth 2300 ha në të cilën kultivohen kryesisht gruri dhe misri.

Perimkultura në komunën e Kaçanikut zhvillohet kryesisht në sipërfaqe të vogla dhe plotëson vetëm nevojat familjare. Bazuar në kushtet e favorshme egzistuese për zhvillimin e pentarisë, në vitet 2002 dhe 2003 janë ngritur plantazhet me pemë ku janë mbjellur më se 250 ha me molla dhe dardha.

Blegëtoria ka kushte të mira të zhvillimit. Sipërfaqet me kullosa dhe livadhe janë në favor të zhvillimit të kësaj dege. Në komunën e Kaçanikut janë 10150 krerë bagëti.

Si në çdo komunë tjetër, edhe në këtë komunë tokave bujqësore po iu ndërrohet destinimi pa leje paraprake. Mbrojtja nga ndërrimi i destinimit të tokave bujqësore kërkon një angazhim shumë të madh duke filluar që nga strukturat më të larta shtetërore deri te ato komunale.

Në komunën e Kaçanikut rreth 70% të familjeve merren me bujqësi, kryesisht për nevoja familjare të cilat vetëm tepricën e prodhimit e nxjerrin në treg.

Burimi i informatave : Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe mbrojtje të Ambientit, Korrik 2004


#### **Rekomandohet :**

- Zhvillimi i politikave për parandalimin e humbjes së tokës bujqësore, si resurs shumë i rëndësishëm në këtë rast për qytetin e Kaçanikut dhe komunën në përgjithësi;
- Zonimi i territorit të komunës (përcaktimi i zonave të cilat do të përdoren vetëm për kultivimin e kulturave bujqësore dhe jo për qëllime tjera);
- Me rastin e zgjerimit të qyteteve dhe vendbanimeve (me planet urbanistike), të mbrohet toka bujqësore sidomos ajo e kategorive I, II, III dhe IV, në harmoni mbi ligjin për tokat bujqësore si dhe kategoritë tjera të tokës të cilat janë nën sistemin e ujitjes.
- Të llogaritet se sa sipërfaqe e tokës kualitative bujqësore humbet për çdo vit në çdo vendbanim dhe në përgjithësi në komunë.
- Që të arrihet një zhvillim i mirëfilltë i bujqësisë në komunë, kërkohet mbrojtje dhe shfrytëzim racional i tokës bujqësore, organizim i mirë shoqëroro-ekonomik, investime në mjete dhe teknologji të punës, teknologji bashkëkohore për një bujqësi intenzive, hapje e mini fabrikave për përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale.

#### **Banimit - kualiteti i banimit**

Çështja e banimit për çdo ditë e më shumë po bëhet më akute, por ajo mund të rregullohet vetëm atëherë kur institucionet tona do të hartojnë planet urbanistike, të cilat mundësojnë funksionimin dhe shfrytëzimin racional të hapësirës. Në zonat për të cilat nuk ekzistojnë planet urbanistike, banimi po përcillet me probleme serioze sanitare. Trualli është kapital i domosdoshëm për ndërtimin e shtëpive. Raporti në mes të banimit në ndërtesat njëbanesore dhe atij në ndërtesat shumëbanesore në komunën e Kaçanikut është : rreth 85% banim individual (në ndërtesat njëbanesore) dhe 15% banim kolektiv (në ndërtesat shumëbanesore). Nëse vazhdon në të ardhmen të mbetet ky raport, për një kohë të shkurtër (disa vjeçare) tokat kualitative do të jenë të shfrytëzuara për ndërtime banimore. Shpërndarja e banimit në distanca të mëdha në hapësirë pamundëson që qytetarët të kenë qasje të kënaqshme në shërbime publike (infrastrukturë, shkollë, ambulante, etj).



Po të analizojmë kualitetin e banimit në aspektin gjeneral, del se kualiteti më i ulët është i shprehur në zonat rurale, në vendbanimet me largësi më të madhe nga qendra (qyteti). Arsyeja qëndron në atë se këto vendbanime i kanë më pak të zhvilluar shërbimet publike, prandaj edhe e kemi të shprehur depopullimin e vendbanimeve. Që të kemi pasqyrë më të qartë të kualitetit të banimit është e domosdoshme të njihet gjendja e infrastrukturës teknike, shërbimeve komunale, hapësirave përcjellëse etj, të cilat në fund do të na japin rezultatin e kualitetit të banimit dhe kualitetin e jetës në përgjithësi. Çështja e banimit trajtohet nga aspekte të ndryshme si kualiteti i jetës, të ardhurat, shkalla e varfërisë, punësimi, arsimimi, infrastruktura teknike, shërbimet publike etj. Të gjitha këto janë të ndërlidhura dhe kanë ndikim të drejtpërdrejtë në kualitetin e banimit.



Kaçaniku dhe Hani i Elezit si komunë numëron rreth 49000 banorë nga të cilët ~30% jetojnë në Kaçanik dhe Han të Elezit ndërsa pjesa tjetër është e shpërndarë në gjithësejt 38 vendbanime tjera. Vendbanimi më i vogël është Naçavci me asnjë banorë për momentin, Dimca me 171 banorë dhe Drenoglava me 149 banorë. Vendbanimet tjera kanë më shumë se nga 200 banorë me një mesatare prej 1225 banorëve për vendbanim. Në bazë të fotografive ajrore karakteristika kryesore e vendbanimeve është se ato janë të tipit të shpërndarë dhe i përgjigjen karakteristikave të përgjithshme të vendbanimeve në Kosovë.

Zona e banimit ne vet qytetin e Kaçanikut ka pesuar ndryshime ne mes dy perjudhave kohore. Në bazë te analizave te bera vet qyteti është rritë me nje mesatare vjetore 3.8 ha.


Zona me sipërfaqe prej 10Km2 _ Kaçaniku				
Veç / periudha	1980	2000	Rritja per 20 vjet	Mes(X) vjetore
Ha	138.63	214.84	76.21	3.8105



### Rekomandime :

- Krijimi i një baze të dhënash për zonat banimore
- Hartimi i Planeve Zhvillimore Komunale dhe Urbane të cilat do ti jepnin një kahje të mirë zhvillimit të komunës
- Përqendrimi i investimeve ne zonat rurale
- Përkrahje ndërtimit të ndërtesave shumëbanesore në mënyrë që të ruhet toka bujqësore
- Sigurimi i banimit social për të pastrehët
- Krijimi i zonave të dedikuara për sport dhe rekreacion për secilin vendbanim
- Krijimi i zonave të dedikuara për parking të automjeteve për vendbanimet urbane



RRITJA URBANE E KAÇANIKUT  
NDËRMJET VITEVE 1980-2000


0 0.2 0.4 0.8 1.2 1.6 Km





### Zonat e rrezikuara nga vërshimet dhe erozioni

Komuna e Kaçanikut është e pasur me burime ujore. Nëpër territorin e komunës së Kaçanikut rrjedhin dy lumenj, Lepenci dhe Nerodimja. Lumi Lepenc buron në malet e Sharrit dhe është i pasur me ujë. Në bazë të të dhënave nga Instituti Hidrometeorologjik, prurja mesatare ujore në pikën matëse në Han të Elezit është  $8.52\text{m}^3/\text{s}$ . Lumi Nerodime buron në malet e Jezercit dhe ka prurje mesatare  $4.06\text{m}^3/\text{s}$  (të dhëna të viteve 1980 - 91 në IHMK)



Në territorin e komunës së Kaçanikut ujrart sipërfaqësor përfshijnë një sipërfaqe prej  $315.03\text{ ha}$  ose  $1.07\%$  nga sipërfaqja e tërë komunës prej së cilës lumenj janë  $213.79\text{ ha}$ , përroje  $99.7\text{ ha}$ , jaz  $1.17\text{ ha}$  dhe kanal  $0.378\text{ ha}$ .

Qeveria lokale e Kaçanikut i ka në plan t'i realizojë dy projekte për lumenjt :

- Rregullimi i shtratit të lumit Nerodime
- Rregullimi i shtratit të lumit Lepenc

Lumi Nerodime përshkon gjatësinë prej afër  $25\text{ km}$  deri në derdhjen e tij në lumin

Lepenc. Kryesisht kalon pjesë të banuara dhe pranë tokës bujqësore, për të vazhduar rrjedhën e tij nëpër qytezën e Kaçanikut ndërsa në dalje derdhet në lumin Lepenc. Meqenëse ka gjatësi të madhe, gjatë vërshimeve shpeshherë shkakton dëme të konsiderueshme. Projekti „Rregullimi i shtratit të lumit Nerodime“ në gjatësi prej  $400\text{ m}$  ka arsyeshmëri të plotë si në aspektin ekonomik poashtu edhe në aspektin e sigurisë së popullësisë nga vërshimet.

Realizimi i këtij projekti do të parandalonte përmbytjen e tokave bujqësore dhe do të mbronte vendbanimet, rrugët dhe hekurudhën nga vërshimet. Gjatë të reshurave të mëdha, Nerodimja rregullisht ka dalur nga shtrati duke shkaktuar dëme të mëdha materiale.

Rregullimi i shtratit të lumit Nerodime krijon mundësi të mira edhe për shfrytëzimin e tokës përgjatë tij për nevoja të bujqësisë.

Lumi Lepenc i cili kalon nëpër territorin e komunës së Kaçanikut, ka rrjedhë shumë të shpejtë për shkak të terrenit malor nëpër të cilin kalon. Gjatë stinëve me të reshura shkakton dëme të mëdha duke dalur nga shtarti dhe vërshuar një numër të madh të tokave bujqësore. Ky lum mbledhë shumë përrocka të cilat poashtu kanë shpejtësi të madhe dhe shkaktojnë dëme të mëdha gjatë vërshimeve. Mbi lumin Lepenc janë disa ura të cilat lidhin shumë fshatra me pjesën e qytetit. Gjatë vërshimeve në të kaluarën ky lum i ka dëmtuar edhe këto ura. Prandaj rregullimi i shtratit të Lepencit do të zvogëlonte shpejtësinë e rrjedhës së lumit, do të parandalonte rrezikun nga erozioni në pjesën malore dhe do të mbronte tokat bujqësore nga vërshimet.

Projekti “Rregullimi i shtratit të lumit Lepenc“ që do të realizohej në një gjatësi lumore prej 2139 metrash, ka arsyeshmëri të plotë si nga aspekti ekonomik poashtu edhe nga aspekti i sigurisë së popullësisë nga vërshimet.

Me realizimin e këtij projekti në mënyrë të drejtëpërdrejtë do të sigurohej një bazë e mirë që pjesa e infrastrukturës komunale pranë të cilës kalon lumi Lepenc, të jetë më e sigurtë.


Rregullimi i shtratit të lumit Lepenc krijon mundësi të mira edhe për shfrytëzimin e tokës përgjatë tij për nevoja të bujqësisë dhe industrisë (të dhëna nga komuna).

Faktorët që ndikojnë në rritjen e shkallës së rrezikshmërisë nga vërshimet janë :

- Çrregullimi natyror i shtratit të lumit (nxjerrja ilegale e inerteve),
- Ngushtimi i shtratit të lumit nga uzurpimet
- Hedhja e mbeturinave të ngurta në shtretërit e lumenjve,
- Mbjellja e bimëve të larta si dhe atyre të vetë-rritura pranë brigjeve të lumenjve etj
- Shkatërrimi i objekteve hidroteknike dhe moskujdesi i vazhdueshëm (argjinaturat) etj.

#### Rekomandimet :

- Rregullimi i shtratit lumor mbi baza natyrore
- Pastrimi i shtratit të lumit nga mbeturinat e ngurta
- Mirëmbajtja dhe ndërtimi i argjinaturave (sipas nevojës)
- Përcaktimi i kritereve profesionale për shfrytëzimin e inerteve si dhe ndalimi i shfrytëzuesve ilegal.
- Eliminimi i pengesave natyrore përgjatë shtratit të lumit etj.



► Sipërfaqet e rrezikuara nga vërshimet

## EROZIONI


Erozioni rrezikon natyrën dhe begatitë e krijuara dhe të planifikuara të njeriut. Ai manifestohet me degradimin e tokës bujqësore dhe pyjore, të bimëve, me bartjen dhe akumulimin e materialit eroziv, i cili ndikon negativisht në tokat bujqësore dhe në vendbanime.

Rreth 6000km<sup>2</sup> ose 56% e territorit të Kosovës është i rrezikuar nga kjo dukuri natyrore të shkallës së I, II dhe III (I - erozion shumë i fortë, II - erozion i fortë dhe III - erozion i mesëm). Edhe në territorin e komunës së Kaçanikut është prezent faktori natyror erozioni që për pasojë ka humbjen e tokës bujqësore dhe dëmet në ekonomitë familjare.

Nga një shkallë e lartë e rrezikshmërisë erozive janë të përfshirë 17464.26ha ose 59.5% e sipërfaqes së komunës. Shkalla e rrezikshmërisë është në rritje si pasojë e faktorëve natyror dhe faktorit njeri. Nga shkalla më e lartë e rrezikshmërisë që e ka kategoria e erozionit shumë të fortë janë të përfshirë 2531 ha tokë. (Shih hartën)


Shkalla e erozionit	Sip.ha	%
Pa erozion	11954.5	40.5
Erozion shumë i dobët		
Erozion i dobët		
Erozion i mesëm	7483.39	25.5
Erozion i fortë	7450.24	25.3
Erozion shumë i fortë	2530.63	8.7

### ► Erozioni në komunën e Kaçanikut





Dukuri negative në komunën e Kaçanikut është edhe rrëshqitja e dheut si pasojë e faktorit njeri. Masat e parandalimit të kësaj dukurie natyrore duhet të ndërmerren urgjentisht nga qeveria lokale dhe ajo qendrore. Dëmet në infrastrukturë, ekonomi, banim etj janë evidente . Rasti i njohur për Kosovën është rrëshqitja e dheut në fshatin Bob e cila fatmirësisht nuk ka patur pasoja në njerëz mirëpo e ka bllokuar rrugën magjistrale për dy muaj. Është vlerësuar se humbja ditore për shkak të bllokimit të rrugës ka qenë rreth 1000000 euro.



Masat mbrojtëse kundër rrëshqitjeve sipërfaqësore janë : drenazhimet e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, muret mbajtëse, pyllëzimi i shpatit me bimësi me lartësi të vogël.

Pasojat e rrëshqitjes në vet qytezën e Kaçanikut ku janë të rrezikuara mbi 20 shtëpi



### Ndotja dhe degradimi i mjedisit

Problemet me të cilat ballafaqohet kjo komunë në lëmin e mjedisit janë të shumta si : ndotja e ajrit, ujit, tokës por edhe eksploatimi i pakontrolluar i resurseve natyrore, i pyjeve etj.

**Ajri** - Si ndotës i ajrit në këtë komunë është fabrika për prodhimin e çimentos “HOLCIM” në Han të Elezit e cila ndotë ajrin me CO<sub>2</sub>, NO<sub>x</sub> dhe me pluhur që vërehet qartë mbi kulmet e shtëpive. Komuna nuk disponon me mjete për matjen e sasisë së ndotjes, prandaj si nevojë e ngutshme shtrohet paisja me këto mjete dhe avansimi i teknologjisë së prodhimit të çimentos në mënyrë që të zvogëlohet ndotja që e shkakton procesi i prodhimit.

**Toka** – Ne këtë komunë është prezente ndotja e tokës edhe pse nuk përdoren shumë preparatet kimike bujqësore si pesticide, fungicide etj. Toka ndotet nga derdhja e mbeturinave të ngurta që ndodhë kryesisht në vendet rurale.

#### Rekomandimet :

- Rregullimi i filtrave ne objektet industriale.
- Menaxhimi i mirë i mbeturinave
- Ripyllëzimi i sipërfaqeve të
- zhveshura në pyje

**Uji** - Territori i komunës së Kaçanikut ka një rrjet hidrografik, i cili i takon pellgut të detit Egje. Në komunë kalojnë dy lumenj Lepenci dhe Nerodimja.


Lumi Lepenc buron në malet e Sharrit dhe deri në bashkimin me ujërat e lumit Nerodime i takon lumenjve me ndotje të kategorisë së parë(lum i pastër). Pas bashkimit me lumin Nerodime, shndërrohet në lum me ndotje të kategorisë II-b. Shkarkimi i ujërave të zeza dhe industriale në Lumin Lepenc rritë shkallën e ndotjes së lumit. Në pjesën e lumit Lepenc që kalon nëpër fshatin Doganaj shkarkohen ujërat e fabrikës së Silkaporit pa një trajtim paraprak.

Lumi Nerodime është me shkallë të ndotjes II-a dhe II-b. Ndotja e ujit të lumit Nerodime është pasojë e shkarkimit të ujërave të zeza të qytetit të Ferizajit dhe fshatrave që shtrihen përgjatë lumit si dhe objekteve industriale.

Shkarkimi i ujërave të zeza në rrjedhjet lumore pa trajtim paraprak rritë shkallën e ndotjes së lumit Lepenc .

Çdo banor shkarkon 16.46m<sup>3</sup> ujra të zeza.

Vetëm Kaçaniku si qytezë me 10049 banorë shakarkon 5.3 l/s ose 165406 m<sup>3</sup> ujra të zeza të patrajuara në lum brenda vitit pa llogaritur këtu objektet shoqërore, industriale etj.



Në bazë të Strategjisë për trajtimin e ujërave të zeza të punuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Finlandës dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor - Departamenti i ujërave, ekzistojnë dy variante për trajtimin e ujërave të zeza :

- Varianti 1 - Trajtim i decentralizuar i ujërave të zeza sipas të cilit çdo qytet / fshat e ka impiantin e vet për trajtimin e ujërave të zeza dhe
- Varianti 2 - Trajtim i centralizuar i ujërave të zeza me vetëm nga një impiant trajtues të ujërave të zeza në secilën prej shtatë kompanive regionale ujore të cilët më vonë do të trajtonin edhe ujjat fekal të zonave rurale. Sipas këtij varianti, komuna e Kaçanikut parashihet të përfshihet në impiantin regional të Ferizajit që është planifikuar të ndërtohet në mes të fshatit Varosh dhe Gerlicë 2 km larg Ferizajit në drejtim të rrjedhjes ujore te lumit Nerodime.



Përveq shkarkimit të ujërave të zeza, lumenjt ndoten dhe degradohen edhe nga mbeturinat që i hedhë popullata lokale, nxjerrja ilegale e rërës, shkatërrimi i florës pranë brigjeve të lumenjve, shpërlarja e tokës gjatë reshjeve atmosferike, nga objektet industriale etj.

**Rekomandimet :**

- Përcaktimi i lokacionit për impiant nga komuna varësisht se cili variant i përshtatet
- Ndalimi i shkarkimit të ujërave indusrial në rrjedhjet ujore .
- Obligimi me ligj që çdo objekt indusrial t'i ketë edhe stabilimentet për pastrimin e ujërave indusrial.
- Rregullimi i shtretërve të lumenjve
- Ndalimi i nxjerrjes ilegale të inerteve nga lumenjt
- Ndalimi i qarkullimit të mjeteve motorike në ujërat e lumenjëve .





**Shfrytëzimi joracional i resurseve natyrore**

Kaçaniku vlerësohet si njëri ndër vendet më të pasura shqiptare me pyje. Bjeshkët e kësaj ane janë të njohura gjithandej në rajon dhe janë joshëse për vizitorët. Disa prej vendeve tërheqëse për vizitorët janë:

- Maja e Lubotenit
- Gryka e Kaçanikut
- Vendshpallja e kushtetutës së Republikës së Kosovës - Shtëpia e Kulturës „Xheladin Kurtaj”
- Bjeshkët e Kaçanikut
- Kalaja e Kaçanikut

Gjatë viteve të 90-ta në territorin e komunës prerjet e pyjeve ishin të shpeshta. Gjatë kësaj periudhe ka ndodhur që në formë „legale”(nga pushteti serb) të prehen edhe nga 20000 m<sup>3</sup> dru për djegje në vit. Kur kësaj i shtohet edhe sasia e prerë ilegalisht atëherë fitohet një sasi shumë më e madhe e masës së prerë drunore. Edhe në periudhën e pasluftës prerjet ilegale janë evidente. Si pasojë e prerjeve në të kaluarën dhe prerjeve të paplanifikuara sot, në komunë kanë mbetur me qindra hektarë sipërfaqe e zhveshur dhe me qindra hektarë pyje të dëmtuar. Prej vitit 1999 - 2003 janë ripyllëzuar vetëm 20 ha të sipërfaqeve pyjore të zhveshura me pishë të bardhë, të zezë dhe hormoq.

Territori i komunës së Kaçanikut është i pasur me minerale. Është konstatuar se në nëntokën e Hanit të Elezit me rrethinë ekzistojnë 15 milionë tonë mergele. Rezervat e gurit gëlqëror në Kepin e Kaçanikut janë në sasi prej 127 milionë tonë, ndërsa rezerva të konsiderueshme ka edhe në afërsi të fshatit Ivajë. Janë konstatuar gjithashtu edhe rezerva të argjilës në lagjen Dushkaja. Eksploatuesit legal të resurseve natyrore - mineraleve janë 4 kompani prej tyre edhe fabrika e çimentos “HOLCIM” në Han të Elezit e cila shfrytëzon mergelen dhe gurin gëlqëror.


Eksploatuesit ilegal janë:

- Kashan-Han i Elezit – rërë
- Han i Elezit – rërë
- Runevë – gurthyes
- Kaçanik – gurthyes

Në fshatin Pustenik gjendet uji termomineral.

**Rekomandimet :**

- Shfrytëzimi racional i resurseve mbitokësore dhe nëntokësore
- Pyllëzimi i pyjeve të zhveshura
- Ndërprerja e funksionit të gurthyesve të palicencuar



### **Historiku i zhvillimit ekonomik të komunës së Kaçanikut**

Ekonomia e tanishme e komunës së Kaçanikut është një ekonomi në tranzicion, e dalur nga lufta me shumicën e kapaciteteve të saj të shkatërruar. Infrastruktura në këtë komunë nuk është në gjendje të mirë. Komuna e Kaçanikut i ka kapacitetet e saj industrial që ka nevojë të avansohen. Mirëpo ekzistojnë edhe kushte të volitshme për zhvillimin e blegtorisë, bletarisë, pentarisë, zejtarisë e në veçanti kushte të mira për zhvillimin e turizmit tranzitor, dimëror dhe veror.

Kaçaniku ka një traditë të hershme të manifakturës dhe privatizmit, sidomos për prodhimin e gurit gëlqeror, rërës, drurit dhe shërbimeve të ndryshme zejtare.

Një faktor i rëndësishëm që ka ndikim pozitiv në zhvillimin e Kaçanikut është pozita e tij në rrugën magjistrale më të frekuentuar në Kosovë në relacionin Prishtinë – Shkup dhe në hekurudhën që lidhë Prishtinën me Shkupin dhe Selanikun në jug dhe me Evropën në veri.

Një pjesë e të ardhurave në komunën e Kaçanikut vjen nga të punësuarit në botën e jashtme. Numri i të punësuarve në botën e jashtme është rreth 5000. Shumë prej tyre përvojën e fituar në këto shtete e aplikojnë këtu duke investuar mjetet e kursyera në aktivitete të ndryshme të bizneseve private.

Momentalisht fabrika e Sharr Cementit në Han të Elezit, e cila është kompleksi më i madh i çimentos dhe materialeve ndërtimore në Kosovë, është punëdhënsi më i madh në regjion.

Renditja e mëposhtme e bizneseve është bërë sipas madhësisë së numrit të regjistrimit të tyre.

1. Tregtia,
2. Të tjera
3. Transporti,
4. Turizmi,
5. Ndërtimtaria,
6. Prodhimi,
7. Shpedicioni

Në shumicën e NVM-ve prodhimi është i vogël. Arësyet për këtë janë : infrastruktura ligjore e pa kompletuar, norma e lartë e kamatës, taksat doganore të pavolitshme, etj.

Bujqësia ka qenë kontribuesi kryesor në zhvillimin ekonomik të Kaçanikut. Prej drithërave më së shumti kultivohen gruri dhe misri. Në bazë të disa vlerësimeve, 50% të të gjithë të punësuarve në sektorin informal i takoin këtij sektori.

Në vazhdim do të japim një pasqyrë mbi shpërndarjen hapësinore të veprimtarive ekonomike që ushtrohen në vendbanimet e komunës së Kaçanikut, ku si çështje e trajtuar është zhvillimi i pabarabartë ekonomik.

### **Zhvillimi i pabarabart ekonomik**


Për të vlerësuar dhe analizuar shpërndarjen dhe gjendjen e veprimtarive ekonomike në komunën e Kaçanikut janë marrë si indikatorë:

- ✓ numri i bizneseve,
- ✓ lloji i bizneseve,


*(Nuk u siguruan të dhënat për numrin e të punësuarve)*

Pas shqyrtimit të të dhënave të regjistrimit të bizneseve në vendbanimet e komunës së Kaçanikut vërehet se numri i bizneseve të regjistruara në fshatrat e komunës është në disproporcion me atë se çka ushtrohet si veprimtari në praktikë në këto lokalitete fshatare. Numri më i madh i bizneseve është në qytetin e Kaçanikut, ndërsa në vendbanimet si : Dimcë, Dramjak, Gabricë, Krivenik, Llanishtë, Natavc, Nikoc, Paldenicë, Rëzhancë nuk ka asnjë aktivitet ekonomik të regjistruar.

Në grafikonin më poshtë janë paraqitur përqindjet e pjesëmarrjeve të aktiviteteve ekonomike të vendbanimeve në numrin e përgjithshëm të aktiviteteve ekonomike të komunës së Kaçanikut.



Në grafikon vërehet se pjesa më e madhe e vendbanimeve është nën mesataren e komunës sa i përket aktiviteteve ekonomike, që do të thotë se është në shkallë shumë të ultë të zhvillimit ekonomik. Disa vendbanime pak më të mëdha si Nikaj, Kovaqec, Godancë, Glllobovicë, Biçec dhe Begracë janë afër mesatares së zhvillimit, ndërsa mbi mesataren e zhvillimit janë vendbanimet Bob, Doganaj, Kacanik i Vjetër, Dubravë e sidomos Hani i Elezit dhe Kaçaniku që janë në shkallë shumë më të lartë të zhvillimit. Në Kaçanik ndodhë gati gjysma e aktiviteteve ekonomike të tërë komunës, ndërsa në Hani të Elezit rreth 25 % e tyre.



Grafiku sipas aktiviteteve më të shpeshta ekonomike

Mungojnë të dhënat për vendbanimet Setishtë, Semajë, Sllatinë, Soponicë, Stagovë, Strazhë dhe Vatë. Këto vendbanime ose janë shumë të vogla dhe të pazhvilluara ku nuk zhvillohen aktivitete përveq atyre për konsum vetanak, ose janë të depopulluara.

Aktivitetet më të shprehura ekonomike janë ato të sektorit të tregëtisë, pastaj vijnë transporti dhe depot dhe në vend të tretë hoteleria. Një renditje e këtillë e sektorëve dominant është edhe në nivel të Kosovës.

Harta e aktiviteteve ekonomike

Në hartë shihet se shumica e aktiviteteve ekonomike zhvillohet përgjatë arteries kryesore rrugore Prishtinë – Shkup, e cila kalon nëpër Kaçanik dhe përgjatë rrjedhës së lumit Lepenc.

### Tregëtia dhe industria

Siq shihet edhe në grafikonin e aktiviteteve më të shumta ekonomike (më sipër), tregëtia është një ndër sektorët dominant ekonomik në komunën e Kaçanikut. Pozita gjeografike e komunës kontribuon shumë për një dominim të tillë të sektorit të tregëtisë. Qyteti i Shkupit është afër territorit të komunës së Kaçanikut dhe në këtë komunë ndodhen dy vendkalimet kryesore kufitare dhe pikat doganore në kufi me Maqedoninë nëpër të cilat hyn 70% e mallit të importuar. Përkundër këtij fakti, komuna e Kaçanikut shkëmbimin tregëtar e kryen kryesisht me Prishtinën dhe Ferizajin.


Kjo renditje e aktiviteteve ekonomike nuk është në përputhje me potencialet zhvillimore të kësaj komune. Në komunën e Kaçanikut ka potenciale për zhvillimin e industrisë përpunuese (druri), industrisë së materialit ndërtimor e cila dikur ka qenë bartëse e zhvillimit dhe punësimit në komunë, ndërtimtarisë, etj. Për momentin këto potenciale industriale, me përjashtim të fabrikës së çimentos në Han të Elezit dhe fabrikës së gëlqeres në Kaçanik, nuk funksionojnë ose punojnë me një kapacitet shumë të kufizuar. Komuna e Kaçanikut posedon pasuri natyrore si mineralin mergele (MT) për prodhimin e materialit ndërtimor dhe lloje të tjera të gurit gëlqeror.

### Bujqësia dhe veprimtaritë e saj në komunën e Kaçanikut

Në komunën e Kaçanikut ekzistojnë kushte të volitshme për zhvillimin e blegtorisë, bletarisë dhe pemtarisë.

Edhe pse të gjitha shënimet tregojnë se komuna e Kaçanikut ka 4215 ha tokë lavërtare, gjendja në terren ndryshon dukshëm. Për arsye të migrimeve të shumta të popullatës fshat – qytet sipërfaqet e mbjellura me kultura lavërtare janë zvogëluar dukshëm. Tani sipërfaqja lavërtare ka 1214 ha dhe në të kultivohen kryesisht gruri dhe misri. Përpunimi i grurit bëhet në mullirin “7 Shtatori” në Matlumë, ndërsa misri kryesisht përdoret për ushqimin e bagëtisë.

Perimkultura në komunën e Kaçanikut kryesisht kultivohet në sipërfaqe të vogla për plotësimin e nevojave familjare. Kushtet për një zhvillim të perimkulturës janë të favorshme, ka toka që janë nën ujtitje por fatkeqësisht sot këto nuk shfrytëzohen. Kjo komunë ka kushte të mira për ujtitje meqë ka një numër të madh të përronjëve dhe dy lumenj të cilët gjatë sezonës verore



kanë ujë të mjaftueshëm. Në sipërfaqet që kanë mundësinë e ujitjes kryesisht kultivohet misri në përzjerje me fasule dhe një pjesë shfrytëzohet për livadhe. Ujitja e sipërfaqeve bujqësore bëhet përmes kanaleve, nuk ka ndonjë sistem modern të ujitjes. Në këtë drejtim duhet të mendohet dhe të përgatitet projekti i ndërtimit të pendës që do të shfrytëzohej për furnizimin e qytetarëve me ujë të pijshëm dhe për ujitjen e sipërfaqeve bujqësore.

Bazuar në kushtet e favorshme egzistuese për zhvillimin e pemtarisë, në vitet 2002 dhe 2003 janë ngritur më se 250 ha plantazhe me mollë dhe dardhë.

Në këtë komunë para luftës kanë ekzistuar dy miniferma të pulave, në Dushkaj me një kapacitet prej 3500 pulash vojse dhe në Elezaj me kapacitet prej 1000 pulash vojse të cilat pas luftës nuk e kanë vazhduar veprimtarinë.

Gjatë luftës, bujqësia e veqanërisht blegtoria dhe mekanizimi bujqësor, kanë pësuar humbje të mëdha. Blegtoria është një sektor me rëndësi meqë familjeve në fshat u ndihmon jo vetëm të sigurojnë ekzistencën e tyre, por tepricat e prodhimeve blegtorale ti hedhin në treg apo të blehen nga industria përpunuese e mishit dhe bylmeteve. Në komunë nuk ka mini ferma të gjedhave. Gjedhat mbahen në ekonomitë familjare dhe produkti kryesor që fitohet prej gjedhave është qumështi. Meqë nuk ka ndonjë qendër grumbulluese të qumështit, ai hidhet individualisht në treg. Në disa ekonomi familjare bëhet përpunimi i qumështit në djath dhe yndyrë. Numri i deleve krahasuar me të kaluarën ka rënë dukshëm. Kjo ka ndodhur më shumë për arësyen e mospajimit të plasmanit, sidomos të qingjave dhe leshit në tregun e brendshëm dhe të jashtëm. Nëse do të sigurohej ky plasman, interesimi për t'u marrë me këtë veprimtari do të vinte në shprehje.

Në komunë janë të evidentuar 184 bletarë me 1569 shoqëri bletësh - koshere. Kjo veprimtari është mjaft e vjetër në këtë komunë. Ekzistojnë kushte të volitshme natyrore për këtë veprimtari. Për shkak të florës së pasur të kësaj treve, kualiteti i mjaltit është i cilësisë së lartë.

**Pylltaria** - Komuna e Kaçanikut posedon një sipërfaqe prej 17302 ha pyje në të dy sektorët. Në sektorin privat janë të evidentuar 5256 ha ndërsa në atë shoqëror 12046 ha. Në këto sipërfaqe pyjore janë të kultivuar ahu, dushku, pisha, shkoza etj. Gjendja e pyjeve nuk është e mirë për arsye të moskujdesit të qytetarëve, të cilët sigurojnë ekzistencën familjare duke i prerë drurët ilegalisht në mënyrë që pastaj t'i shesin. Në vitin 2003 janë ripyllëzuar 10 ha me ç'rast fidanet i ka siguruar Agjencioni i Pyjeve të Kosovës.

Në komunën e Kaçanikut ekziston stacioni i veterinarisë, mirëpo nuk është në funksion. Ky stacion është pronë e komunës. Këshillat nga bujqësia dhe blegtoria jipen nga drejtorati përkatës pranë KK dhe nga veterinarët në ordinancat private.

### **Turizmi dhe potencialet turistike**

Në territorin e komunës së Kaçanikut, me përjashtim të disa objekteve hoteliere dhe dy pishinave, nuk ka infrastrukturë adekuate si parakusht të nevojshëm për zhvillimin e turizmit.

Komuna e Kaçanikut ka potencial të jashtëzakonshëm natyror, dallohet me kushte të volitshme topografike dhe klimatike, pozitë mjaft të mirë për zhvillimin e turizmit. Ky potencial qëndron në shpatijet e Sharrit, grykën e Kaçanikut dhe pasuritë ujore (lumenjt Lepenci dhe Nerodimja). Një segmetnt i rëndësishëm është mundësia e zhvillimit të turizmit tranzit. Ekzistojnë parakushtet për këtë lloj turizmi sepse nëpër territorin e kësaj komune hyhet nga Maqedonia në Kosovë dhe pikat kufitare hyrëse janë më të frekuentuarat në Kosovë. Me këtë rast turistëve tranzitorë, përveq monumenteve të natyrës, u ofrohen edhe monumentet kulturo – historike të kësaj treve.

Maja e Lubotenit dhe shpatijet piktoreske të Sharrit ofrojnë mundësi të shkëlqyeshme për zhvillimin e turizmit malor.

Nga vitet e 80-ta ekziston plani për qendrën rekreative sportive “Livadhet e Shtrazhës”. Realizimi i këtij projekti do t'i shërbente zhvillimit të turizmit dimëror dhe veror.

Synim i kahershëm ka qenë dhe është shfrytëzimi i bukurive natyrore duke realizuar projekte të ndryshme.

Lokacioni i qendrës sportive, turistike dhe rekreative është zgjedhur në vendin e quajtur “Gurët e zi” në rrugën Prishtinë-Tetovë, në lartësi mbidetare prej 996m deri në 1283m, mbi malet e quajtura “Tupani i Vogël”, “Tupani i Madh” dhe “Rrafshi i Zanave”. Klima e përshtatshme dhe konfiguracioni i terrenit mundësojnë vendosjen e pajisjeve sportive dimërore.

Në rrëzë të Majës së Lubotenit, në lartësi mbidetare prej 1000 metrash deri në 1200 metra do të vendoset fshati sportiv dhe turistik.




Në vitin 2002 është hartuar edhe një projekt ideor për qendrën turistike sportive “Kaçaniku” në shpatijet e Sharrit, por ende nuk ka diçka konkrete lidhur me këtë.

Duke u çmuar lartë rëndësia e realizimit të këtij projekti jo vetëm për Kaçanikun por edhe për regionin si tërësi, hapësira prej 300 ha është shpallur zonë me interes të posaqëm, nga ana e KK të Kaçanikut. Meqenëse organet komunale tani për tani nuk kanë kompetencë të shesin apo të japin me qira tokë apo objekte komunale për më shumë se 10 vjet, KK i Kaçanikut në vazhdimësi i është drejtuar me shkrim Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit me kërkesën që të lejojë dhënjën në shfrytëzim të hapësirës së përkufizuar për ngritjen e Qendrës sportive, turistike dhe rekreative “Kaçaniku”, në kohëzgjatje më shumë se 10 vjet. AKM është bërë një nga faktorët pengues për realizimin e këtij projekti.

Monumentet kulturo – historike që e bëjnë më atraktive ofertën turistike të kësaj treve janë kalaja që gjendet në qendër të qytetit të Kaçanikut e ndërtuar në fund të shekullit XVI (1595) dhe xhamia e Kaçanikut e nërtuar nga veziri i madh Koxha Sinan pasha në vitin 1594.

Varrezat e dëshmorëve të Dardha dhe Puset e Nikës si dhe shumë pllaka përkujtimore dhe lapidarë të paskonfliktit të vitit 1999, paraqesin një potencial turistik, p.sh. për ekskurziona të ndryshme për nxënës, studentë, grupe të ndryshme etj.



### Rekomandime :

Qëllimi i analizës hapësinore të territorit të komunës së Kaçanikut, përveq tjerash, është edhe identifikimi i nivelit të zhvillimit ekonomik për çdo vendbanim të komunës, shikimi i mundësive për një zhvillim të barabartë dhe identifikimi i faktorëve që ndikojnë në gjendjen e tanishme .

Në hartën ku është paraqitur shkalla e aktiviteteve ekonomike sipas vendbanimeve, shihet qartë se të gjitha zhvillimet ndodhin përgjatë arteries rrugore Prishtinë - Shkup, e cila kalon nëpër Kaçanik, pastaj përgjatë rrjedhës së lumit Lepenc e gjithashtu në dy pikat doganore të cilat e lidhin Kosovën me rajonin.

Arësytet e një koncentrimi të këtillë të zhvillimit janë lidhja e mirë rrugore dhe hekurudhore në ato zona, furnizimi më i mirë me energji elektrike, toka pjellore përgjatë lumenjve, mundësia për ta shfrytëzuar ujin e lumenjve për ujtitje etj.

Ndërkaq arësytet për moszhvillimin e shumë vendbanimeve janë infrastruktura teknike më pak e zhvilluar, mungesa e shërbimeve publike dhe pozita e tyre si zona kufitare me veprimtari të kufizuara. Kjo gjendje ka shkaktuar migrimin

e popullësisë drejt qendrave ku kualiteti i jetës është më i mirë duke krijuar kështu dukurinë e depopullimit të vendbanimeve. Për shkak të mungesës së banorëve në disa fshatra, janë shuar aktivitetet ekonomike në to. Ato pak familje që kanë mbetur në disa fshatra merren me prodhime bujqësore sa për konsum familjar ose sigurojnë të ardhura prej diasporës.

Pozita e volitshme gjeografike e komunës së Kaçanikut, lidhja e mirë rrugore dhe hekurudhore (Prishtinë - Shkup - Selanik) e cila ofron mundësi të mira për transportin e mallrave, dy pikat kufitare - doganore me Maqedoninë nëpër të cilat hyjnë 70% të mallrave të importuara në Kosovë, pastaj lënda e parë që përdoret për industrinë ndërtimore, tradita në industrinë ndërtimore, konfiguracioni shumë atraktiv i malit të Sharrit, struktura e re e popullësisë e aftë për punë, numri i madh i njerëzve të punësuar jashtë atdheut, sipërfaqet e mëdha të kullosave, janë kualitete që i krijojnë komunës mundësi reale për një zhvillim në këto fusha të rëndësishme ekonomike :

- Tregti,
- Blegtori dhe bujqësi,
- Industri ndërtimore, përpunuese,dhe
- Turizëm




**Rekomandime - tregëti**

Banorët e komunës së Kaçanikut shkëmbimin tregtar e kryejnë kryesisht me Prishtinën dhe Ferizajin. Pozita e volitshme, lidhja e drejtpërdrejt me Maqedoninë përmes dy pikave kufitare – doganore, mundëson që kjo komunë të jetë urë lidhëse kryesore për shkëmbimin tregëtar të Kosovës me rajonin.

Do të duhej që plani zhvillimor komunal dhe plani zhvillimor urban të kishin politika favorizuese që do të mundësonin një zhvillim më të shpejtë të tregtisë në komunë pasi që kjo parashikohet edhe në PH të Kosovës.

Gjithashtu komuna në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës do të duhej të krijonte politika favorizuese në interes të zhvillimit të NVM (ndërmarrje të vogla dhe të mesme).

Me plane rreguluese urbane do të krijoheshin zonat ekonomike ku do të koncentroheshin aktivitetet ekonomike.

**Rekomandime - industri përpunuese**

Potencialet natyrore që i ka komuna e Kaçanikut, traditat në industrinë përpunuese dhe kapacitetet njerzore e bëjnë të nevojshëm stimulimin e industrisë përpunuese krahas një monitorimi të vazhdueshëm të shfrytëzimit të lëndës së parë. Është e nevojshme të hartohet dhe pastaj të zbatohet plani i veprimit për shfrytëzimin e lëndës së parë. Në industrinë përpunuese do të duhej të aplikohet një teknologji e avansuar që do të mbronte mjedisin nga ndotja.

**Rekomandime - bujqësia dhe blegtorja**

Si në çdo komunë tjetër edhe në këtë komunë tokave bujqësore po iu ndërrohet destinimi pa leje paraprake. Mbrojtja nga ndërrimi i destinimit të tokave bujqësore, sidomos të tokave të kategorive I deri IV, është imperativ i kohës dhe kërkon një angazhim shumë më të madh si nga

pushteti lokal ashtu edhe nga ai qendror. Për këtë është i nevojshëm edhe një propagandim i vazhdueshëm për vetëdijesimin e qytetarëve.

Në komunën e Kaçanikut rreth 70% të familjeve merren me bujqësi. Me këtë aktivitet ato i plotësojnë nevojat e veta, kurse tepricën e prodhimit e hedhin në treg. Stimulimi i bujqve për kultivimin e grurit është një nevojë me përparësi. Në komunë ka kushte të mira për zhvillimin e perimkulturës sidomos në luginat e lumenjve. Kjo do të mund të bëhet duke ngritur serrat për perime me ç'rast bujqit do të përfitonin njohuri për kultivimin e perimeve në serra.

Kushtet janë mjaft të volitshme edhe për zhvillimin e shpeztarisë. Kërkesat për vezë janë të mëdha. Ngritja e minifermave për lopë qumështore, minifermave për dele dhe ngritja e punkteve grumbulluese të prodhimeve blegtorale (qumështit) apo të ndonjë stacioni për grumbullimin e qumështit do të kontribuonin për zhvillimin e blegtorisë. Për këtë qëllim gjithashtu nevojitet një kujdes i mirëfilltë veterinar që do të ndikonte edhe në përmirësimin e racave. Meqë në komunë ka kushte të mira për zhvillimin e një bletarie intenzive, është e nevojshme ngritja e një qendre për grumbullimin dhe përpunimin e mjaltit.

### **Rekomandime - turizëm**

Ngritja e qendrës turistike rekreative - sportive "Kaçaniku" në shpatijet e Sharrit, pastaj realizimi i projektit që ekziston nga vitet e 80-ta për qendrën rekreative sportive të quajtur "Livadhet e Shtrazhës", si dhe ndërlidhja e monumenteve kulturo-historike në ofertën turistike, do të mundësonin ndryshimin e strukturës ekonomike në nivel komunal. Efektet ekonomike do të kishin qenë të shumëfishta, sepse këto qendra do të nxisnin edhe shumë aktivitete ekonomike jashtë veprimtarisë së tyre, që nga shtimi i transportit, shtimi i prodhimit të artikujve ushqimor, nxitja e bujqve që të merren me përpunimin e produkteve bujqësore, shërbimet e ndryshme tregtare etj. Taksat e qëndrimit të vizitorëve dhe taksat tjera do të plotësonin buxhetin komunal.

## Vendbanimet, infrastruktura dhe shërbimet

### Pozita gjeografike

Komuna e Kaçanikut gjendet në juglindje të Kosovës me një sipërfaqe prej 306 km<sup>2</sup>, që përbën 2.85 % të tërësisë territoriale të Kosovës. Komuna e Kaçanikut kufizohet në jug me IRJ Maqedonisë, në lindje me komunën e Vitisë, në veri me komunën e Ferizajit, ndërsa në perëndim me komunën e Shtërpces. Në kuadër të komunës bëjnë pjesë 42 vendbanime, me 49200 banorë.

Distancat nga qyteti i Kaçanikut deri tek disa vendbanime të Kosovës janë :

Kaçanik-Gjilan.....	45 km
Kaçanik-Ferizaj.....	21 km
Kaçanik-Viti.....	25 km
Kaçanik-Prishtinë.....	58 km
Kaçanik-Shtërpce .....	22 km
Kaçanik – Han i Elezit...	12 km..
Kaçanik - Qafëshqipe (Gllloboçicë)..	34 km....

### Transporti rrugor

Komunën e Kaçanikut e përshkon mes për mes magjistralla (M2) Prishtinë – Shkup, arterie kryesore që lidhë Kosovën me Maqedoninë dhe që ka rëndësi të posaçme për zhvillimin e tregëtisë, turizmit dhe ekonomisë në përgjithësi. Rrugë tjetër me rëndësi është rruga rajonale Doganaj - Gllloboçicë e cila gjithashtu lidhë Kosovën me Maqedoninë me një konfiguracion të terrenit shumë atraktiv që ofron mali i Sharrit me kushte të jashtëzakonshme për zhvillimin e turizmit.

Rruga kryesore për në Maqedoni që kalon nëpër qytetin e Kaçanikut është në gjendje relativisht të mirë me dëmtime të vogla. Gjendja e rrugëve që lidhin fshatrat është e keqe, përdërisa në brendi të fshatrave rrugët janë të parregulluara dhe në të shumtën e rasteve të paasfaltuara.


Gjatësia totale e rrjetit rrugor në komunën e Kaçanikut është 226.90 km, prej së cilës, rrugë magjistrale janë 26 km (të asfaltuara diku rreth 161000m<sup>2</sup>), rrugë regjionale janë 28 km (të asfaltuara 196000 m<sup>2</sup>), rrugë të asfaltuara lokale janë 17.6 km dhe rrugë të paasfaltuara janë 155.30 km apo shprehur në sipërfaqe 544200 m<sup>2</sup> të cilat janë në gjendje të keqe dhe përdoren më pak.

Rrugë magjistrale	26 km	11.5
Rrugë regjionale	28 km	12.3
Rrugë lokale të asfaltuara	17.6 km	7.7
Rrugë lokale të pa asfaltuara	155.3 km	68.4
Gjithsej	226.9 km	100 %


Rrjeti rrugor brenda qytetit karakterizohet me rrugë të ngushta, pa trotuare dhe me degëzime tjera, gjithashtu të ngushta dhe me pjerrtësi të theksuar që ndoten shpesh nga ujëra të zeza.

Sistemi i drenimit të rrugëve është i rregulluar në rrugët magjistrale, regjionale dhe pjesërisht në qytetin e Kaçanikut.

Sipas të dhënave të marra nga institucionet komunale të Kaçanikut nga gjithësejt 42 vendbanime të komunës, vetëm 10 vendbanime kanë rrugë të asfaltuara apo rreth 24% e vendbanimeve të komunës. Në këto vendbanime jeton rreth 57% e popullatës së komunës. Në 6 prej këtyre vendbanimeve rrugët e asfaltuara janë të dëmtuara (shih grafikoni).



Në hartë është paraqitur shtrirja hapësimore e rrugëve : rruga magjistrale M2, rrugët e asfaltuara dhe rrugët e pa asfaltuara nëpër vendbanime.



## Urat

Në territorin e komunës së Kaçanikut janë gjithësejt 35 ura me gjatësi prej 675 m, prej të cilave 7 ura metalike në vijën hekurudhore Fushë Kosovë – Shkup në pjesën Kaçanik i Vjetër – Stagovë – Kaçanik - Han i Elezit. Gjatësia e këtyre urave është 105 m. Gjashtë ura prej betonit të armuar gjenden në rrugën magjistrale Prishtinë - Shkup, në pjesën Fusha e Pajtimit – Kaçanik - Han i Elezit. Gjatësia e këtyre urave është 210 m. Katër ura prej betonit të armuar janë në rrugën regjionale Fusha e Pajtimit – Tetovë, pastaj Fusha e Pajtimit – Doganaj - Qafëshqipe. Gjatësia e këtyre urave është 55 m. Në Han të Elezit janë 2 ura prej betonit të armuar dhe 1 urë metalike për këmbësorë gjatësia e të cilave është 60 m.

Një urë prej betonit të armuar është mbi lumin Lepenc, te uji i thartë, në rrugën e Puseve të Nikës me gjatësi prej 20 m. Një urë tjetër prej betonit të armuar mbi lumin Lepenc, në rrugën e Lumbardhit ka gjatësinë 18 m. Në qytetin e Kaçanikut janë 2 ura prej betonit të armuar, njëra mbi lumin Lepenc dhe tjetra mbi lumin Nerodime dhe një rrugë metalike mbi lumin Nerodime. Gjatësia e këtyre urave është 55 m. Ura që gjendet në rrugën e Timorit mbi lumin Lepenc është në gjendje shumë të keqe. Gjatësia e saj është 18 m.

Ura të tjera janë si vijon :

- Një urë prej betonit të armuar në rrugën e fshatrave Bicaj dhe Nikë me gjatësi 25 m.
- Një urë prej betonit të armuar në rrugën e Lirishtës me gjatësi 17 m
- Një urë e drurit për këmbësorë mbi lumin Lepenc në Doganaj me gjatësi 20 m.
- Një urë druri mbi lumin Nerodime, në Runevë me gjatësi 12 m.
- Dy ura prej betonit të armuar mbi lumin Nerodime në Stagovë me gjatësi 12 m.
- Një urë prej betonit të armuar mbi lumin Nerodime, në Kaçanik të Vjetër me gjatësi 20 m.
- Dy ura të kombinuara metal-dru në Korbali me gjatësi 16 m.

Projektet prioritare të komunës

Rrugë me prioritet të lartë dhe me ndikim të madh në të gjithë aspektet e jetës shoqërore dhe ekonomike të banorëve të Komunës së Kaçanikut janë :

- 1) Rruga që lidhë qendrën me fshatrat: Bob, Kovaçec (Trimor), Biçec (Bicaj), Nikë, Rekë (Malësi), Dubravë (Llirishtë), Soponicë (Sopot), Doganaj etj. ka rëndësi të veçantë sepse jo vetëm që lidhë 1/3 e popullsisë me qendrën (afro 15.000 banorë), por krijon perspektiva të reja (dhe të vetme) në shtrirjen urbanistike të qytetit. Gjendja momentale e rrugës është pothuajse e pakalueshme.
- 2) Rruga që lidhë qendrën me fshatrat: Runjevë, Stagovë, Kaçaniku i Vjetër dhe Begracë, gjithashtu është e rëndësishme për lidhje më të mirë të komunës me këto fshatra.
- 3) Rrugë tjetër me një rëndësi të veçantë është rruga që lidhë qendrën me fshatrat: Gajre, Ivajë, Kotlinë dhe Gllaboçicë sepse të gjitha këto fshatra janë malore dhe banorët e tyre shprehin tendencë permanente për shperngulje drejt qendrës.

Projektet prioritare të komunës për infrastrukturën rrugore për vitin 2006 janë :

- Asfaltimi i rrugës në Kovaçec;
- Asfaltimi i rrugës „Rakoci” në Kaçanik;
- Ndërtimi i urës mbi lumin Lepenc në Dubravë;
- Rehabilitimi i rrugës në fshatin Gjurgjedell;
- Rregullimi i parkingut te „Varrezat e Dëshmorëve”;
- Asfaltimi i rrugës „Ismail Qemali”;

Projektet prioritare të komunës në infrastrukturën rrugore për vitin 2007 janë :

- Asfaltimi i rrugës Dallosh-Doganaj;
- Asfaltimi i rrugës në fshatin Koxhaj;
- Asfaltimi i rrugës në fshatin Kotlinë;
- Asfaltimi i rrugës në fshatin Bob;
- Asfaltimi i rrugës „Ramadan Agushi” në qytet;
- Asfaltimi i rrugës „Agim Bajrami” në qytet (rruga kah teqja);
- Ndërtimi i urës mbi lumin Nerodime në Kaçanik;

Projektet prioritare të komunës në infrastrukturën rrugore për vitin 2008 janë :

- Asfaltimi i rrugës në fshatin Stagovë;
- Asfaltimi i rrugës në fshatin Elezaj;
- Asfaltimi i rrugës në fshatin Sllatinë;
- Asfaltimi i rrugëve në lagjen „UÇK” dhe „Migjeni”;
- Asfaltimi i rrugës së lagjes „Dushkaja”;

Projektet prioritare të komunës në infrastrukturën rrugore për vitin 2009 janë:

- Asfaltimi i rrugës në fshatin Duraj;
- Asfaltimi i një aksi rrugor me infrastrukturë përcjellëse në vendbanimin Dushkaja;

Burimet e financimit të projekteve janë:

- Granti i BKK-së,
- Prej të hyrave vetanake komunale dhe
- Prej participimit nga vet komuniteti

### **Rekomandime :**


Infrastruktura rrugore si bazë elementare e zhvillimit të gjithëmbarshtëm të një territori kërkon trajtim të posaçëm nga të gjithë faktorët me ndikim në këtë sektor. Si prioritet i parë duhet të jetë rehabilitimi dhe asfaltimi i rrugëve ekzistuese dhe hapja e rrugëve të reja.

Nevojat për investime në rrugët e komunës janë shumë të mëdha dhe nuk mund të mbulohen nga buxheti komunal, prandaj priten donatorë të cilët së bashku me komunitetin do të investonin në hapjen e rrugëve të reja që janë parakusht për zhvillimin e gjithëmbarshtëm të komunës dhe sidomos të fshatrave që janë më larg qendrës së qytetit të Kaçanikut.

### Transporti publik rrugor

Shërbimi i transportit publik rrugor (transporti i udhëtarëve me autobus) është pjesë e transportit rrugor i cili në komunën e Kaçanikut ka shtrirje në 11 vendbanime. Në komunën e Kaçanikut nga gjithsej 42 vendbanime, vetëm në 11 vendbanime apo 26 % të vendbanimeve të komunës zhvillohet transporti publik rrugor. Nga shërbimi i

transportit publik rrugor janë të përfshirë rreth 27500 banorë apo rreth 56% të banorëve të komunës së Kaçanikut. Vendbanimet në të cilat zhvillohet transporti publik rrugor janë : Biçec, Doganaj, Dubravë, Gajre, Ivajë, Kaçanik, Kaçanik i Vjetër, Rekë, Stagovë, Vatë dhe Hani i Elezit.



### Transporti hekurudhor


Për dallim nga shumica e komunave tjera të Kosovës, në komunën e Kaçanikut, ndonëse me kapacitet të vogël, funksionon edhe transporti hekurudhor. Nëpër territorin e kësaj komune kalon vija hekurudhore Fushë Kosovë – Shkup me një gjatësi prej 24 km. Përgjatë kësaj rruge gjenden 4 stacione. Gjendja e binarëve hekurudhor dhe e stacioneve hekurudhor është e keqe. Binarët hekurudhor kalojnë nëpër këto vendbanime : Kaçanik, Kaçaniku i Vjetër, Runjevë, Stagovë dhe Hani i Elezit, kurse stacionet hekurudhore gjenden në këto lokalitete : Kaçanik i Vjetër, Stagovë, Kaçanik dhe Hani të Elezit.

Nga gjithësejt 42 vendbanime në komunën e Kaçanikut, vetëm në pesë prej tyre shtrihen binarët hekurudhor, apo në 12% të vendbanimeve të komunës. Në këto vendbanime jetojnë 39% të banorëve të komunës.

### Rekomandime :



Meqenëse transporti publik rrugor në komunën e Kaçanikut zhvillohet edhe në rrugët e paasfaltuara, këto rrugë do të duhej të kenë përparësi për t'u asfaltuar. Asfaltimi i tyre pason me një transport publik më të rregullt dhe më komfor. Gjithashtu është e nevojshme që shërbimi i transportit publik rrugor të zgjerohet edhe në vendbanimet tjera sepse tani vetëm 56% të banorëve të komunës janë të përfshirë nga ky shërbim.

Sa i përket infrastrukturës së transportit hekurudhor, paraqitet nevoja për riparime dhe investime në ngritjen e nivelit të saj, pasi që ajo aktualisht është në gjendje shumë të amortizuar.



### Furnizimi me ujë të pijshëm

Edhe pse komuna e Kaçanikut është e pasur me burime të shumta ujore këto burime nuk shfrytëzohen në mënyrë racionale.



Sistemi publik i ujësjellësit është i instaluar në 19 vendbanime nga gjithsej 42 vendbanime apo shprehur në përqindje në 45% të vendbanimeve, në të cilat jeton 63% e popullsisë së komunës (31235 banorë).

Sistemet e furnizimit me ujë të pijshëm në komunën e Kaçanikut përbëhen nga ujësjellësi me gravitacion, pompat dhe pusët ose ujësjellësit për familje, grupe familjesh ose lagje të vogla të cilat nuk i përmbushin standardet e parapara. Gjatësia e rrjetit primar është 106.8 km, ndërsa e rrjetit sekondar është 70.9 km. Për pjesën e popullatës e cila ka rrjet ujësjellësi sasia e ujit është 120 l/24 orë. Të gjithë ujësjellësit janë me gravitacion përpos ujësjellësit të Gorancës, i cili është i kombinuar, me gravitet dhe pompa. Me gjithë investimet e mëdha, ende ka nevoja

të shumta për investime në rrjetin e ujësjellësit, si në : Stagovë, Shtrazë etj.

Projektet prioritare të komunës për furnizimin e popullatës me ujë janë :

- Shtimi i kapaciteteve të ujësjellësit në fshatin Doganaj;
- Ndërtimi i ujësjellësit Kaçanik i Vjetër - Begracë


## Rrjeti i kanalizimit të ujërave fekale

Kanalizimi i ujërave fekale dhe atyre atmosferike gjendet para një shkatërrimi të plotë në qytet për shkak të vjetërsisë së rrjetit, ndërkaq nëpër fshatra as që ekziston sistemi i kanalizimit, përveç ndonjë pjese të vogël të vetorganizuar. Trajtimi i ujërave të zeza bëhet përmes gropave në sipërfaqe të hapura që rrezikojnë përhapjen e sëmundjeve ngjitëse.

Në rrjetin e kanalizimit në qytetin e Kaçanikut kanë qasje 7537 banorë apo 75 % të banorëve të qytetit. Në qytet rrjeti i kanalizimit ka një gjatësi prej 1330 metrash, i cili në shumë pjesë nuk funksionon për shkak të vjetërsisë dhe kapacitetit të vogël. Në disa pjesë të qytetit derdhja e ujrave të zeza bëhet përmes disa përrockave pa kurrëfarë trajtimi, që ndotin

ambientin dhe lumenjtë Lepenc dhe Nerodime (është llogaritur se ndotja e lumenjve në komunën e Kaçanikut është 161 litra /24 orë). Në disa pjesë të qytetit mund të sanohet rrjeti i kanalizimit, ndërsa në disa pjesë duhet të shtohet kapaciteti i gypave.

Rrjeti i kanalizimit të ujërave fekal shtrihet vetëm në 4 vendbanime apo në 10 % të vendbanimeve të komunës së Kaçanikut ku jetojnë 10350 banorë apo 21 % të banorëve të komunës së Kaçanikut, ndërsa 38 vendbanime apo 90% e vendbanimeve të komunës me 38840 banorë apo rreth 79 % e popullsisë nuk kanë rrjet të kanalizimit (shih skemën). Vendbanimet me rrjet të kanalizimit janë: Kaçaniku, Kaçaniku i Vjetër, Hani i Elezit dhe Gllloboçica.



## Rekomandime

Me gjithë investimet e bëra nga ana e donatorëve të ndryshëm si dhe të vet Kuvendit Komunal, nevojat për investime në sistemin e ujësjellësit dhe kanalizimit janë të mëdha. Duhet të bëhen investime si në rrjetin e ujësjellësit ashtu edhe në atë të kanalizimit në mënyrë që të zgjidhet apo të zbutet problemi i furnizimit të qytetarëve me ujë të pijshëm dhe i ndotjes së ujrave nëntokësorë dhe tokës me ujra të zeza. Gjithashtu që të shmanget ndotja e lumenjve me ujra të zeza të patrajtuara më parë, është shumë i nevojshëm investimi për ndërtimin e impiantit për trajtimin e ujrave të zeza.

## Projektet prioritare të komunës


Projektet prioritare të komunës për sistemin e kanalizimit të ujërave fekale për periudhën 2006-2009 janë:

- Ndërtimi i kanalizimit fekal në lagjen „Dushkaja” në Kaçanik;
- Ndërtimi i kanalizimit fekal në Han të Elezit;
- Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatin Bob;
- Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatin Dubravë (faza e II-të);
- Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatin Biçec;
- Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatin Doganaj;
- Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatin Kovaçec;
- Ndërtimi i impiantit për pastrimin e ujërave të zeza;

## Shërbimi i largimit të mbeturinave

Shërbimi i grumbullimit të mbeturinave në komunën e Kaçanikut ka funksion mjaft të vogël. Ky lloj shërbimi funksionon vetëm në pesë vendbanime të komunës.

Vendbanimet në të cilat funksionon shërbimi i largimit të mbeturinave






janë: Kaçaniku, Hani i Elezit, Duraj, Elezaj, Runjeva. Pra, nga 42 vendbanime të komunës së Kaçanikut vetëm 5 vendbanime e kanë këtë lloj shërbimi që do të thotë 12% të vendbanimeve të komunës, apo sipas numrit të popullsisë rreth 33% e popullsisë.


### Rekomandime


Duke marrë parasysh shtrirjen e shërbimit të largimit të mbeturinave në komunën e Kaçanikut dhe numrin e popullatës të përfshirë në këtë shërbim, kjo çështje mbetet një sfidë e madhe për zhvillimin dhe zgjerimin e saj edhe në pjesët tjera të komunës. Pra, rekomandohet që shërbimi i largimit të mbeturinave të zgjerohet në tërë territorin e komunës.



### Furnizimi me energji elektrike


Përkundër investimeve të konsiderueshme nga donatorë të ndryshëm, ka nevojë për investime tjera për riparimin e rrjetit të shpërndarjes dhe ndërrimin e trafove në shumë lokalitete. Nevojë imediate është trafostacioni prej 110 KW në Kaçanik, përmirësimi i rrjetit të tensionit të ulët në pjesën e vjetër të qytetit, ndërtimi i një trafoje në qytet, rrjeti i tensionit të lartë vija Bob- Ivajë - Gurëzi (ish Shtrazë).





## Posta dhe telekomunikimet

Posta dhe telekomunikacioni karakterizohet me teknologji shumë të vjetruar. Centrali telefonik, me kapacitet prej 1412 numrave, është i teknologjisë së viteve të gjashtëdhjeta dhe as për së afërmi nuk i plotëson nevojat e qytetarëve. Në rrjetin e telefonisë fikse përfshihen 16 vendbanime apo 38% të vendbanimeve të komunës së Kaçanikut, mirëpo kapaciteti i centralit telefonik është i vogël. Nga ky central kënaqen nevojat e vetëm 1412 familjeve apo të rreth 8470



banorëve, shifër kjo që paraqet 17.2% të popullsisë së komunës. Fakti që ekzistojnë vetëm 1412 numra telefonik apo 3 numra në 100 banorë flet për nivelin e ultë të zhvillimit të telefonisë fikse në komunën e Kaçanikut. Nga sistemi i telefonisë mobile mbulohet rreth 85 % e territorit të komunës së Kaçanikut.

## Rekomandime

Nevojat e popullatës por edhe të institucioneve për komunikim modern dhe të shpejtë janë shumë të mëdha. Prandaj është nevojë imediate zgjerimi, modernizimi dhe digjitalizimi i telefonisë fikse në qytet dhe rrethinë, sikundër shtrirja e rrjetit të telefonisë fikse digjitale në të gjitha vendbanimet e komunës në të ardhmen jo të largët.


Nga harta e mëposhtme shihet se zhvillimi i përgjithshëm i infrastrukturës në komunën e Kaçanikut është i ulët, ku rreth 64% e vendbanimeve gjenden nën mesataren e zhvillimit të komunës.

## Zonimi i territorit sipas nivelit të përgjithshëm të zhvillimit të infrastrukturës teknike në komunën e Kaçanikut

### Legjenda

Niveli i zhvillimit të infrastrukturës teknike nëpër vendbanime

- Nën mesataren komunale
- Në mesataren komunale
- Mbi mesataren komunale
- Kufij ndërkombëtarë




## Projektet prioritare të komunës së Kaçanikut

### Legjenda

Prioritetet e komunës

- Kufij ndërkombëtarë
- Njësi kadastrale
- Asfaltimi i rrugëve
- Asfaltimi i rrugëve, kanalizimi
- Asfaltimi i rrugëve, ndërtimi i urave, kanalizimi
- Kanalizimi
- Ndërtimi i urave, Kanalizimi
- Ujësjellësi



Në hartën e mësipërme janë paraqitur projektet prioritare të infrastrukturës teknike në komunën e Kaçanikut (asfaltimi i rrugëve, ndërtimi i urave, rregullimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit).

### **Rajonalizimi i problemeve dhe mundësive**

Në zhvillimin e komunës së Kaçanikut, ndikimi i rrugës magjistrale M2 në relacionin Prishtinë – Hani i Elezit – Shkup, në të gjitha çështjet që janë shtruar në këtë analizë hapësinore është i dukshëm. Zhvillimet e viteve të fundit, përveç në këtë korridor rrugor, po ndodhin edhe në korridorin tjetër rrugor në relacionin Doganaj – Qafshqipe. Relievi (konfiguracioni natyror) i luginave të lumenjve Lepenc dhe Nerodime me tokë kualitative bujqësore dhe me mundësi ujitjeje, me infrastrukturë teknike e sociale më të zhvilluar, me komunikim dhe shërbime solide, me vendbanime më të mëdha dhe numër më të madh të banorëve, janë parakushte për një zhvillim më të shpejtë të kësaj pjese të komunës së Kaçanikut e sidomos për zhvillim të bujqësisë.


Në bazë të analizave të bëra, si zona me probleme më të shprehura dhe nën mesataren e zhvillimit, janë zonat në terrenet kodrinore-malore ku nuk ekzistojnë parakushtet e përmendur më lartë. Andaj në këto zona janë më të shprehura : varfëria me shkaktarët e vet të shumtë siç janë papunësia e madhe, sipërfaqja e vogël e tokave kualitative bujqësore, kushtet më të pafavorshme për shtrirjen e infrastrukturës teknike, kuadri arsimor e shëndetësor më i paktë etj. Si pasojë e kësaj paraqitet dukuria e depopullimit të këtyre zonave. Ndërkaq qendra urbane e ka problemin e mbipopullimit. Për shkak të tij, hapësirat shkollore dhe të qendrës shëndetësore bëhen të pamjaftueshme.

Humbja e tokës bujqësore nga ndërtimet e pakontrolluara në të është një problem tjetër në komunën e Kaçanikut. Nga analiza e bërë për zonën urbane del se kufiri urban është rritur në drejtim të rrugëve më të frekuentuara dhe të tokave bujqësore. Në vitin 1948 kishte 428 shtëpi banimi në zonën urbane, kurse në vitin 1999 kishte 1279 shtëpi banimi.


Kahjet e zhvillimit të vet qendrës së qytetit janë paraparë në drejtim të rrjedhës lumore të Lepencit deri në Doganaj.

Në komunën e Kaçanikut mjedisi po ndotet e po degradohet nga derdhja e ujërave të zeza dhe industriale të patrajtuara në lumenj e me mundësi të depërtimit edhe në ujërat nëntokësor, nga nxjerrja e paplanifikuar e inerteve nga lumi, hedhja pa kriter e mbeturinave në lumenj dhe brigje të tyre gjë e cila shton rrezikun për vërshime, nga prerjet ilegale të pyjeve dhe shfrytëzimi joracional i tyre që si pasojë përveq tjerash kanë edhe erozionin, nga gurëthyesit, nga djegja e karburanteve në makinat e vjetruara e pa katalizator dhe nga gazrat industrial.

Problemet dhe mundësitë që i ka komuna e Kaçanikut (disa prej problemeve janë paraqitur në hartën e mëposhtme) duhet të trajtohen në mënyrë specifike në momentin e hartimit të politikave zhvillimore komunale.




Në hartën e mëposhtme shihet se zonat që janë mbi mesataren e zhvillimit të komunës së Kaçanikut ndodhen përgjatë rrugës magjistrale në relacionin Prishtinë – Hani i Elezit, ndërkaq shumica e zonave që janë nën mesataren e zhvillimit ndodhen më larg kësaj rruge, në pjesët kodrinore malore.




Në komunën e Kaçanikut bartës kryesor të zhvillimit sot janë fabrika e çimentos në Han të Elezit, kapacitetet për përpunimin e gurit gëlqeror në Kaçanik, fabrika e materialit ndërtimor – gazbetonit në Doganaj dhe rruga magjistrale M2 në relacionin Prishtinë – Hani i Elezit – Shkup. Si bartës të zhvillimit të ardhshëm në zonat kodrinore-malore janë resurset natyrore (mali Sharr) të përshtatshme për zhvillimin e turizmit malor, sportiv, rekreativ, shëndetësor dhe të gjuetisë. Fondi i kullosave këtu ofron mundësi të zhvillimit të blegtorisë e parakushtet janë edhe për zhvillimin e bletarisë dhe gjuetisë.

Bartës i zhvillimit edhe në të ardhmen në komunën e Kaçanikut do të jetë korridori rrugor përgjatë magjstrales M2 por edhe vija hekurudhore Prishtinë - Shkup.

Pikat kufitare në Han të Elezit dhe në Qafshqipe, gjithashtu janë katalizator të zhvillimit.



Në hartën më poshtë shihen zonat që duhet të jenë të mbrojtura nga ndërtimet. Në tokat bujqësore të kategorive I – IV, ndërtimet duhet të jenë shumë të kufizuara dhe kuptohet vetëm me plan, ndërsaq në zonën e parkut nacional „Mali Sharr”, deri në përpilimin e planit hapësinor për këtë park, nuk bën të ndërtohet fare. Poashtu në zonat me pasuri nëntokësore siq është guri gëlqeror nuk duhet të ndërtohet fare në të ardhmen.





**Treguesit dhe kriteret për vlerësim****1. Varfëria e lartë dhe në rritje:**

Treguesit

Numri i banorëve me asistencë sociale

Numri i familjeve me asistencë sociale

Kriteri

- % e popullsisë së vendbanimit që marrin asistencë sociale:

0 - 4 % - tregon varfëri të ulët

4 – 22 % - varfëri e mesme

Mbi 22 % - varfëri e lartë

**2. Papunësia e lartë dhe në rritje të vazhdueshme:**

Treguesit

Numri i punëkërkuessve të paraqitur në zyrën komunale për punë dhe punësim

Kriteri

- % e të pa punëve në raport me tërë popullsinë e vendbanimit

0 – 6 % - papunësi e ulët

6 – 18 % - papunësi e mesme

Mbi 18 % - papunësi e lartë

**3. Depopullimi i vendbanimeve:**

Treguesit

Numri i banorëve sipas vendbanimeve në vitin 1998

Numri i banorëve sipas vendbanimeve në vitin 2003

Mesatarja e rritjës së popullsisë

Numri i përsoneve të mbytur gjat luftës.

Kriteri

- % e popullsisë së shpërngulur sipas vendbanimeve prej vitit 1998 deri 2003

0 – 30 % - depopullim i vogël

30 – 80 % - depopullim i lartë

Mbi 80 % - depopullim shumë i lartë

**4. Shërbimet e ulëta arsimore dhe shëndetësore:**

Treguesit

Objektet shëndetësore/nr. banorëve

Kuari shëndetësor/nr. banorëve

Kuari përkatës – kualifikimi i përsoneve mjekësor

Largësia e shërbimeve shëndetësore

Sipërfaqja shkollore/ nr. i nxënësve

Kuari arsimor/ nr. i nxënësve

Kuari përkatës – kualifikimi i mësimeve

Largësia e objekteve shkollore

Kriteret për shëndetësi:

I mjek dhe 2 motra medicinale / 2000 banorë

I ambulancë / 6000 banorë

I QMF / 10 000 banorë

I QKMF / 60 000 banorë

Kriteret për arsim:

5 m<sup>2</sup> / I nxënës

22 nxënës / 1 mësues

## 5. Shkatërrimi i trashëgimisë natyrore dhe kulturore:

Treguesit

Numri i objekteve kulturo-historike

Numri i objekteve arkeologjike

Lista e objekteve (zonave) natyrore të cilat IMNK-ja i propozon për mbrojtje

Kriteret

- Numri dhe rëndësia e objekteve me trashëgimi kulturo-historike sipas vendbanimeve

## 6. Humbja e tokës bujqësore:

Treguesit

Sipërfaqja e tokës bujqësore në komunën e Vushtrrisë në të gjitha fshatrat

Të dhënat nga Agjencioni Kadastral i Kosovës

Kriteri

- % e sipërfaqës së tokës bujqësore sipas vendbanimeve

15 – 31 %

31 – 47 %

47 – 63 %

63 – 79 %

Mbi 79 %

## 7. Banimi:

Kriteri

- Merren vlerësimet e qështjeve tjera (infrastruktura, shërbimet komunale, hapësirat përciellse etj.), të cilat japin si rezultat kualitetin e banimit dhe të jetës në përgjithësi

## 8. Zonat e rrëzikuara nga vërrshimet dhe erozioni:

Treguesit

Të dhënat nga atlas: Baza e hidroekonomisë së Kosovës

Të dhënat komunale për zonat e rrëzikuara nga vërrshimet

Kriteret:

Vendbanimet dhe sipërfaqet e tokave bujqësore të rrëzikuara nga vërrshimet.

Shkalla e erozionit (I, II, III, IV, V).

## 9. Ndotja degradimi dhe shfrytëzimi joracional i mjedisit:

Treguesit

Të dhënat komunale për ndotjen dhe degradimin e mjedisit

Të dhënat nga IHMK (Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës)

Të dhënat nga dokumenti – Strategjia e mjedisit

Rapor mbi gjendjen ambientale në Kosovë

Kriteret:

Shkalla e ndotjes në bazë të kriterëve të përcaktuara nga UE

Deponit ilegale në vendbanime

Shkarkimi i ujrave të zeza

Vendshfrytëzimet ilegale të pasurive natyrore

## 10. Zhvillimi i pabarabart ekonomik:

Treguesit

Informatat mbi organizimin e bizneseve, veprimtarit dhe numrin e të punësuarve në fshatrat e komunës së Vushtrrisë

Organizimi i bujqësisë

Potencialët turistike

**Kriteret:**

Numri i bizneseve dhe llojit të bizneseve për bashkësi lokale.

Numri i serave dhe lloji i tyre nëpër vendbanime

Vlerat natyrore për potencial turistik

**II. Vendbanimet, shërbimet dhe infrastruktura:****Treguesit**

Vendbanimet nëpër të cilat kalojnë rrugët e asfaltuara

Vendbanimet të cilat kanë shërbimet e transportit publik

Të dhënat për transportin hekurudhor

Të dhënat për furnizim me energji elektrike

Vendbanimet të cilat kanë rrjetin e ujësjellësit

Vendbanimet të cilat kanë rrjetin e kanalizimit dhe ujërave fekale

Vendbanimet të cilat janë të përfshira në largimin e mbeturinave

**Kriteret :**

% e vendbanimeve të komunës të cilat i kanë rrugët e asfaltuara

% e VB-ve të komunës të cilat i kanë të organizuar shërbimet e transportit publik\

% e VB-ve të komunës të cilët e kanë transportin hekurudhor

% e VB-ve të komunës të cilët e kanë rrjetin e ujësjellësit dhe % e banorëve të kyqur në të.

% e VB-ve të cilat e kanë rrjetin e kanalizimit dhe % e banorëve të kyqyr në të

% e VB-ve të cilat janë të përfshira në rrjetin e grumbullimit të mbeturinave dhe % e popullsisë të përfshira në të.

## **Bashkëpunëtorët dhe përgjegjësit:**

**Instituti për Planifikim Hapësinor**

Përgjegjës kryesor - Luan Nushi U.D. drejtor

*Përgjegjës për programin e analizave hapësinore - Arbën Rrecaj*

Përgjegjës për projektin - Shpend Agaj

Përgjegjës për qështje të caktuar - *Besim Gollopeni  
Luljeta Orana  
Festa Nela  
Zana Mehmeti  
Mimoza Kallaba  
Rizah Murseli  
Ismail Gagica*

*Kuvendi Komunal - Kacanik*

*Strukturat e ndryshme komunale (të gjitha drejtoratet e KK të Kacanikut)*

## ***Burimi i informatave***

Një pjesë e madhe e të dhënave të përgjithshme për të gjitha qështjet janë marrë nga shërbimet komunale.

Përgjegjës nga ekzekutivi kumunal janë:

Hajrush Devolli-bashkpuntor përgjegjës K.K Kaçanik - MMPH-IPH

Xhevdet Kuka

Enver Zharku